

NAIM BUJUPI

**RRUGËTIMI I SHKOLLËS
SHQIPE NË ARLLAT
1928 - 2008**

Monografi

**Prishtinë
2008**

Redaktor:
Riza GREIÇEVCI

Lektor:
Jonuz FETAHAJ

Korrektor:
Autori

Fotografitë i bëri:
“Egzoni”, Isuf Bujupi - Kamaran

Në ballinë:
Në 80-vjetorin e themelimit të shkollës së parë shqipe në Arllat
Fotografia e kolektivit të shkollës - 2003

Realizimi kompjuterik
Valon J. Fetahu
Prishtinë

U shtyp në shtypshkronjën
GRAFOPRINT
Prishtinë

*Zogu ka dalë nga gëzhoja,
nuk ka fuqi që e shti më aty ku ishte.*

Adem Demaçi

*Nëse do të dish, mik, vërtet sa shumë të dua,
më trego:
Sa herë ke vdekur për popullin tënd?
Sa të kuqe e ke lirinë?
Sa të lirë e ke Atdheun?*

Riza Greiçevci

*Sa më e madhe që është vështirësia,
aq më e vlefshme është fitorja.*

Ciceroni

NJOHURI PËR ARLLATIN

Arllati, Llapushniku dhe Negroci, janë tri fshatra që shtrihen në mes të Vargmaleve të Berishës dhe Kasmaqit. Këto fshatra gjenden në një fushëgropë. Kjo fushëgropë nga lindja hapet me Grykën e Llapushnikut, në veri me Grykën e Tërdecit, në perëndim me Grykën e Vërmicës dhe në Jug me Tërpezën.

Kjo fushëgropë në pjesën Lindore e ka Gradinën e Llapushnikut, në Veri Gradinën e Vuçakut, në perëndim Gradinën e Zatriqit dhe në jug Gradinën e Lladraviqit, pra ky territor mbulohet me këto katër Gradina.

Arllati gjendet 15 kilometra në jugperëndim të Drenasit. Ky fshat drenicar është i ndarë në këto lagje:

- Lagjja Bujupi
- Lagjja e Xhamisë
- Lagjja Bytyçi
- Lagjja Gjergjaj dhe
- Lagjja Fanaj.

Ky lokalitet i Drenicës është i pasur me mikrotoponime, ndër të cilat po përmendim:

Kodra e Lithit, Lugu i Kurtit, Shavarina, Livadhet e Plepave, Azmiqet, Fusha e Pulës, Rrafshi, Fusha e Rabaxhisë, Te Ura e Ali Kadrisë, Varri i Gjakovës, Kroni i

Karanocit, Akrenca, Lugidon, Ujëmiri, Kroni i Shenjtë, Guri i Rrafshit, Te Kisha, Shkëmbi i Shqiponjës, Kroni i Kishës, Kroni i Halit Shurdhës, Drumet e Pejës, Varrezat e krushqëve, Varri i të pajohurit e të tjera.

Rreth emrit Arllat janë të lidhura shumë legjenda dhe kallëzime, të cilat sikur përgënjeshtrojnë etimologjinë e emrit të sotëm. Po përmendim faktin se në ecje të kohës pleqtë ualënë në kujtesë brezave të rinj emrin Orllat. Pse Orllat? Sepse, siç mbahet mend, vetë Stefan Nemanja, gjatë rrugëtimit nomad nëpër këto anë të trojeve etnike shqiptare, kthen në kishën katolike ilire në Deçan. Në Arllat kisha katolike ilire nuk rrënohet - shpëton. Me dylbi Stefani serb vëren Bjeshkët e Berishës dhe në rrëzë të tyre diçka, sipas tij, po rrezaton. Pyet bashkëpunëtorët e vet: a janë rrënuar të gjitha kishat? Po, i kishin thënë ata. Epo, ç'po rrezaton në ato rrëza bjeshkësh? Orlat, Orlat! (shqiponjat), i thonë bashkëpunëtorët. Përditë grumbullohen nëpër kurora lisash dhe sikur bëjnë roje nëpër bjeshkë dhe rrafshë të kësaj toke ilire.

Shpina e orlave është me pendla të bardha dhe ato pendla ta qasin rrezatimin e bardhë, Stefani ynë.

Bile, i thonë Stefanit, të vetët, morëm vesh se i tërë ky lokalitet është i mbushur me orla. Janë të mëdhenj, të shpejtë si vetëtima, të guximshëm dhe sogjetarë. Nëpër bjeshkë e male të lashta orlat janë mbretër.

Shumë majë malesh, gur e bjeshkë, kishin marrë emrin e tyre.

Në vitet e shtatëdhjeta u lind një ide nga intelektualët që shkronja “O” Orllat të hiqet fare, dhe në vend të saj të vendoset shkronja “A”:

Arllat e jo Orllat, sepse, kjo “O” ka aromën sllave.

Po pse pra Arllat? Historianët thonë se fjala Arllat vjen nga Ara e Latës.

Disa të tjerë mëtojnë të pandehin se fjala Orllat, Arllat, vjen nga fjala “Urlë” që domethënë vjebër për bylmet, ngase ky territor që moti njihej si malor me blegtori të zhvilluar, andaj, mendja ta merr, se origjina e fjalës Arllat është më afër me fjalët “Yrlë- Yrlas-Urlë-Urlas, ose Orl-Orlat.Ndërsa termi Arë+Latë=Arlat është me origjinë të vonë, sepse në shekullin 18 në këtë vendbanim paraqitet emri me origjinë turke, Latif.

Siç shihet, historikisht është bërë një lëvizje e shkronjës së parë duke ndryshuar edhe kuptimin e emërtimit të fshatit.

Një kodër e lidhur me Gradinën e Llapushnikut, është quajtur Akrenca. Aty mbahet ndërmend të ketë qenë një godinë në formë kalaje. Aty banorët kanë vërejtur gjurmë të lashtësisë dhe të kulturës materiale. Po ashtu, në Mëhallën e Xhamisë ka ekzistuar një kishë e vjetër iliro-shqiptare. Supozohet se pas kalimit të popullatës në fenë islame, jo larg saj është ndërtuar xhamia. Afër kësaj kishe janë gjetur disa varreza të moçme me skelete të varrosur në mënyrë vertikale.

Në këtë vendbanim, pas disa viteve të jetës në Pejë, vjen familja muhaxhire shqiptare Pashinca, por sipas disa fakteve, në këtë vendbanim në vitin 1878 deri më 1912 kishte jetuar edhe familja Vishesella.

Ndërmjet dy luftërave botërore, pushteti serb sjell tetë familje malazeze kolonë. Këta kolonë malazez vendosen në Livadhet e Plepave, në tokën më pjellore të fshatit dhe në pjesë tjera të fshatit.

Më 1871, në kuadër të Bajrakut të Astrazubit kishte 50 shtëpi shqiptare, në fund të shek. XIX kishte 90 shtëpi, në dy lagje, të gjithë shqiptarë. Sipas regjistrimit të vitit 1913 Arllati kishte 397 banorë, në vitin 1918 kishte 70 shtëpi shqiptare me 500 banorë, në vitin 1921 kishte 73 shtëpi dhe 601 banorë, në vitin 1948 kishte 128 shtëpi, dhe 969 banorë, në vitin 1953 kishte 137 shtëpi dhe 1225 banorë, prej tyre 1219 ishin shqiptarë, 2 serbë, 4 të tjerë, në vitin 1971 kishte 161 shtëpi dhe 2199 banorë, prej tyre 2198 shqiptarë dhe vetëm një serb.

Pas mbarimit të Luftës Çlirimtare të Kosovës, Arllati kishte 433 shtëpi, me 3199 banorë, duke përfshirë edhe lagjen Gjergjaj. Dora e barbarëve rrënoi 232 shtëpi të kategorisë III-IV dhe dogji 163 shtëpi.

Këto janë fakte e argumente të dala nga Kuvendi Komunal i Drenasit, kurse faktet e shënimit e banorëve të Arllatit dëshmojnë se para luftës UÇK-së ky fshat kishte 285 familje me 2538 banorë. Këto fakte pohojnë se gjatë luftës armiku dogji 138 shtëpi, rrënoi 67 shtëpi dhe 80 i demoloi krejtësisht.

Po ashtu, zjarri i armikut serb shkatërroi dy objektet e shkollave fillore, dogji e përdhosi dokumentacionin e tyre, shkatërroi ambulancën dhe kultin e fesë islame, xhaminë, e ndërtuar më 1728, dhe më 1 prill 1999 u shkatërrua krejtësisht. Katër persona janë zhdukur, tre prej të cilëve janë gjetur dhe identifikuar në varrezat kolektive, ndërsa një ende nuk është gjetur.*

* Dr. Jusuf Osmani: “*Vendbanimet e Kosovës*” - Drenica, faqe 185.

Në Arllat gjatë luftës së UÇK-së janë vrarë 19 veta, prej tyre dy femra.

Nga të vrarët 6 janë dëshmorë, 12 janë martirë dhe një ende konsiderohet i zhdukur.

Celulat e para të arsimit shqip

Ishte viti shkollor 1928/29, kur në fshatin e Arllatit filloi mësimi laik, karshi atij fetar. Lejen për fillimin e mësimi laik e dhanë autoritetet e atëhershme të Serbisë, jo me gjithë aq vullnet e dëshirë, sa për të mashtruar qendrat e vendosjes së Evropës, të cilat kishin dhënë disa herë vërejtje për mosrespektimin e të drejtave të pakicave. A thua shqiptarët shumicë në Kosovë atëherë ishin vërtet pakicë, kjo dihej dhe dokumentohej me fakte e argumente, se shqiptarët ishin popull autokton në trojet e veta stërgjyshore, mirëpo, pushteti i Serbisë përpiqej të fshihte macen në thes, duke mos treguar natalitetin e shqiptarëve dhe duke propaganduar gjithandej Evropës së pakicat në Kosovë gëzonin të gjitha të drejtat që u takonin, bile kishin të drejta të tepërta. Një kësi “marifeti” diskriminues dhe robërues Serbisë ia mësonte ashiqare kush tjetër pos vëllait të saj Ruisë, e cila në vendin e vet kishte probleme të mëdha me pakicat.

Së pari mësimi filloi në fshatin Balincë, në një shtëpi private të Istref Kelmendit, dhe tek pas tre muajve mësimdhënia transferohet në Arllat, po ashtu në shtëpi private. Për nevoja të mësimi të fëmijëve shqiptarë shpejt e shpejt ndërtohet një shtëpi private, në pronën e Bajram Hel

Bujupit, i cili kreu detyrën e korrierit të shkollës dhe mu për këtë arsye bashkëfshatarët ia dhanë epitetin Bajram Shkolla.

Në fillim vijimi i nxënësve ishte tepër i dobët. Nuk tregonin gjithaq interesim fëmijët për shkollën, sepse, iu kishte ngulitur në kokë mendimi se shkolla prish e helmon njeriun, e largon nga shtëpia e prindërit, e largon nga feja e nga vetvetja. Në fillim mësimet i vijonin 48 nxënës, të gjithë meshkuj, çka forcon bindjen tonë që e thamë më lart, se vijimi i fëmijës në shkollë konsiderohej atëherë si shmangie nga udha e Zotit, e fesë dhe e së mbarës, sidomos kjo bindje më e fuqishme dhe tepër kryençe, kur ishte fjala e shkollimit të vajzave shqiptare. Mësues ishte një malazez, që quhej Radoje Llalliq. Urrejtjen dhe shovinizmin ndaj shqiptarëve, e sidomos ndaj shkollës dhe shkollimit të fëmijëve shqiptarë, nuk arriti t'i fshehte, sepse, i fyente, i rrihte, i përbuzte dhe i përqueshte fëmijët shqiptarë, duke i konsideruar kafshë me bisht.

Në një bisedë që zhvillova me ish nxënësin e gjeneratës së parë, z. Zeqir A. Dobruna, me pati thënë se: “Një herë mësuesi Llalliq na pyeti se cilit komb i përkasim? Ne si fëmijë që ishim nuk ditëm t'i japim përgjigje. Atëherë na porositi ti pyesim prindërit tanë në mbrëmje dhe të nesërmen ti tregojmë. I pyetëm prindërit për pyetjen që na bëmë dhe ata pa e peshuar mirë këtë pyetje na thanë se jemi turq. Përgjigjen e prindërve e përcollëm te mësuesi të nesërmen. Mësuesi na tha, e mirë atëherë a e dini ju gjuhën turke? Jo, i thamë. Pra, cilën gjuhë e flisni në shtëpitë tuaja? Shqip, i thamë. Atëherë, pse thoni që jeni turq. Ju flisni shqip dhe jeni shqiptarë.

Barbarizmi dhe varfëria shpirtërore e morale e atij “mësuesi” malazez ishte hetuar qartë nga prindërit, e sidomos, kur fëmijët shqiptarë as në oborr të shkollës, as në korridor, as në lojë e as në klasë, e lëre më gjatë rrugës shkollë-shtëpi të guxonin të folnin shqip ndërmjet vete. Jo, jo, nuk guxonin nga shkopi dhe rrahja brutale e mësuesit çetnik nga Andrijeviçica e Malit të Zi.

Po ai ish nxënës më tregoi se mësuesi Llalliq ka vdekur nga kafshimi i qenit të tërbuar. Në shkollë ishin përfshirë nxënës nga të gjitha fshatrat si: Arllati, Llapushniku, Balinca dhe dy nxënës nga Budakova e Suharekës.

Po japim emrat dhe mbiemrat e nxënësve të atëhershëm që vijonin mësimin në shkollën e Arllatit:

1. *Sinan Demir Bujupi - Arllat*
2. *Hasan Din Bujupi*
3. *Jetish Imer Bujupi (nuk është në foto)*
4. *Shaip Hajdin Bujupi*
5. *Ukë Zymer Bujupi*
6. *Manush Osman Bujupi*
7. *Mehmet Isuf Bujupi*
8. *Rexhep Shaqir Bujupi*
9. *Islam Isuf Gashi*
10. *Rrahman Abaz Gashi*
11. *Imer Sefer Gashi*
12. *Izet Smajl Morina*
13. *Isa Zenun Bytyçi*
14. *Latif Jashar Bytyçi*
15. *Mehmet Haqif Selimi - Budakovë (Haqifi ishte xhandar në Arllat)*

16. *Haki Haqif Selimi - Budakovë (nuk është në foto)*
17. *Rexhep Ibrahim Gashi - Llapushnik*
18. *Zeqir Tahir Gashi*
19. *Nezir Zukë Gashi*
20. *Bajram Rexhep Gashi*
21. *Rizah Isuf Gashi*
22. *Bislim Halit Gashi*
23. *Tahir Miftar Berisha*
24. *Hamëz Zeqir Thaçi (nuk është në foto)*
25. *Liman Hazir Thaçi (nuk është në foto)*
26. *Avdi Ramosh Thaçi*
27. *Raif Halil Thaçi*
28. *Murat Isuf Thaçi*
29. *Xhemë Isuf Krasniqi - Negroc*
30. *Halil Miftar Krasniqi*
31. *Haxhi Selim Krasniqi*
32. *Nush Osman Osmani (Krasniqi)*
33. *Liman Hysen Gashi - Balincë*
34. *Sefer Ramadan Gashi*
35. *Vesel Dervish Kelmendi*
36. *Minush Bajram Kelmendi*
37. *Bajrush Tahir Bujupi - Arllat (nuk është në foto)*
38. *Emin Shaban Gashi (nuk është në foto)*
39. *Ali Halil Gashi*
40. *Tafë Isë Bytyçi*
41. *Haxhi Bajram Bytyçi*
42. *Emrush Reshit Aga - Balincë*
43. *Hetem Islam Thaçi - Llapushnik*
44. *Zeqir Tafil Krasniqi - Negroc*
45. *Sadik Asllan Krasniqi*

46. Bajram Metë Krasniqi

47. Islam Hajriz, Thaçi - Balincë

48. Zeqir Ahmet Dobruna - Arllat



Brezi i parë i shkollarëve në vitin 1928/29 në Arllat

Vërejtje: Identifikimin e nxënësve në fotografi e bëri Zeqir Ahmet Dobruna, ish-nxënës i këtij brezi të shkollës, 1929.

Llalliq, me fëmijët shqiptarë në Arllat, punoi hiç më pak se deri në vitin 1936/37. Pas shkuarjes së tij, që gëzoi pa masë, sidomos fshatarët e Arllatit dhe të fshatrave përreth, erdhi tjetri gjarpër, Nikola Nikoliq, mësues nga Gjakova. Ky mësues me fëmijët shqiptarë punoi deri në vitin 1941, kur fuqitë e mëdha, Italia, Gjermania dhe sllavët, pushtojnë Kosovën.

Plaku i urtë e mentar Tahir Berisha, u thotë burrave:

- Ne shqiptarët liri e kulturë të shtetit do të kemi tek atëherë kur vajza shqiptare bëhet pilot barabar me mashkullin! Ose kur gjyshja i thotë nipit ose mbesës shko dhe sillma gazetën, të shoh se ç'shkruan shtypi sot.

Pas Luftës së Parë Botërore, Ramë Bllaca, në kullën tonë jep porosinë gjithandej shqiptarisë që patjetër të dërgohen edhe vajzat në shkollën shqipe. Një popull i shkolluar meriton lirinë, kulturën, Evropën.

Në cilësinë e deputetit, jep emra për shkollim:

- I pari, thotë Rama, djali im, Qazim Bllaca, Rasim Bujupi, Shaqir Bujupi, Brahim Lah Gashi, Llapushnik, dhe Asllan Fazlia.

Të gjithë këta djem i regjistron në Medresenë e Madhe të Shkupit. Më pastaj Qazim Bllaca vazhdon shkollimin edhe më tutje. Rasimi, Shaqiri dhe Brahimi në vend të detyrës së hoxhës marrin detyrën e mësuesit. Rasimi emërohet mësues në Rozhajë, Shaqiri në Plavë, Brahimi në Dragash e Kaçanik.

Në vitin 1950 Brahim Lah Gashi mësues në Kaçanik, arrestohet dhe dënohet për pushkatim, mirëpo, dënimi i kthehet në 20 vjet burgim. Njëmbëdhjetë vjet burg i mban në Goli-Otok. Ky ishte anëtar i shoqërisë “Drita” të Arllatit.

Ministria e Arsimit e Mbretërisë së Tiranës, me kërkesën e Rrahim Bujupit, truproje e Qazim Bllacës, Rasim dhe Shaqir Bujupi, transferohen në Carrallukë dhe Glllogoc me 1940/41.

Disa të rinj tinëzisht mësonin alfabetin shqip në abetare. Mësues dhe përhapës i parë i shkronjave shqipe në mejtep ishte Mulla Rexhepi nga Tërpeza. Tashmë ishte themeluar shoqëria “Drita”, si degë e asaj në Stamboll, që vepronte përmes Shkupit. Edhe në Arllat vepronte kjo shoqëri ilegale. Bartja e librave - abetares dhe të tjerave, bëhej nëpërmes Shkupit. Këta libra i sillnin: Ukë Plakiqi, Rashit Plakiqi, Hajdin Shaqir Bujupi, Lah Gashi, Hazir Latifi, Vesel Pagarusha, Zeqë Bajram Gashi. Ndërsa shpërndarjen e bënin adhuruesit e librit shqip dhe anëtarë të shoqërisë “Drita”, Xhemë Lahi, Brahim Lah Gashi, Rrahim Shaban Bujupi, Ajet Abaz Gashi e të tjerë.

Libri shqip sillej dhe shpërndahej në mënyrë ilegale dhe mësimi zhvillohej në shtëpinë e Isuf Hajdar Thaçit nga Llapushniku.

Ja një detaj shumë interesant i treguar nga Brahim Lah Gashi, i cili thotë:

-Më kujtohet që një herë në javë mbanim mësim në gjuhën shqipe. Një herë mulla Rexhepi, pas mësimit mbi fenë i ndali disa nxënës tek prindërit e të cilëve kishte besim. E mbylli derën me shul, shpalosi flamurin kombëtar dhe na tha: "Tani do të mësojmë shqip nga ky libër. Për këtë nuk bënë të ju tregoni të tjerëve, ndërsa me prindër të juaj bisedoj unë".

Në shkollë atëherë mësonim: Abetaren, Histori, Gjeografi dhe Dëshmorët e Rilindjes.



Brahim Lah Gashi me bashkëshorten dhe autori i librit

Siç shihet, në mes të dy luftërave botërore në trevën tonë mesimi zhvillohej në tri gjuhë: mësimi laik në gjuhën serbe, mësimi mbi fenë në gjuhën arabe, ndërsa ilegalisht mësimi zhvillohej në gjuhën shqipe.

Pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore thuaj se asgjë nuk ndryshoi për të mirë tek shqiptarët e Kosovës. Kinse filloi një organizim më i ri i shkollimit të pakicave në Kosovë.

Në vitin shkollor 1945/46 për mësues në Arllat vjen Shyqri Palloshka nga Gjakova. Mungonte gjithçka shkollore e pedagogjike: shkolla, rendi shkollor dhe higjienik, pastërtia dhe rregulli pedagogjik.

Ishte hera e parë që mësimi tash zhvillohej në gjuhën shqipe, në mënyrë gjysmëlegale, sepse ishte nën mbikqyrje.

Mësimi zhvillohej në shtëpinë-shkollë, pronë e Tahir Muharremit, kurse mësuesi flinte në kullën e tij. Mësuesi Shyqri ishte në moshën 75 vjeçare, dhe sipas bisedave të fshatarëve ai kishte qenë sekretar i Bajram Currit dhe këndej kishte ardhur për të humbur gjurmë.

Tani temë ishte senzibilizimi i popullatës për dërgimin edhe të vajzave në shkollë krahas djem.

Nëpër kulla e tubime flitej e pritej se kush i pari do thyej akullin e të dërgojë vajzën në shkollë.

Një herë në një tubim ishte zhvilluar kjo bisedë:

Mulla Maliqi i Drenocit:

- Burra, pasha Zotin pa Atdhe nuk ka as lumturi, as fe!

Bajram Haliti nga Arllati:

- Arma më e fortë kundër shfarosjes së bimës së keqe nga trojet etnike stërgjyshore është shkolla. Ne duhet t'i shkollojmë, edhe djemtë, edhe vajzat, barabar. Kjo është udha e Zotit, udhë e drejtë.

Nëse shkau vajzës së vet ia prenë fustanin deri në gju, ne vajzave tona fustanin t'ua premë dy gishta mbi gju.

Halit Bujupi:

- Plak, (Bajramit) nëse ti e dërgon çikën tënde, Kadën në shkollë, qe besa e të Madhit Zot edhe unë po i dërgoj dy çikat e mija, Salijen dhe Hatixhen.

Destan Metë Bujupi:

- Pas jush unë do ta dërgoj Zyrafeten temë!

Hamit Gashi:

- Burra, jua jap besën se edhe unë në shkollën shqipe do t'i dërgoj vajzat e mia, Ajnishahen dhe Fetijen.

Rrahim Bujupi:

- Që sot për hajr i qoftë vajzës teme, Fatimes udha e shkollës shqipe!

Ismail Bujupi:

- Hajr qoftë, edhe unë po e dërgoj në shkollën shqipe vajzën teme, Bahtijen.

Hamit Sejdi Bujupi:

- Edhe unë do ta dërgoj Shemsien time në shkollë.

Nezir S. Gashi:

- Vajza ime, Libadja që sot e ka lejen teme dhe të Zotit për të shkuar në shkollën shqipe.

Sherif Bujupi:

- Shehidja jeme që sot mund të bëhet gati për t'u nisur për shkollën shqipe.

Tash numri i nxënësve po thuaj se ishte dyfishuar. Në kullën e Bajram Halit Bujupit, para burrave, Bajrami, zëshëm paska thënë, se armikun mund ta mposhtim vetëm me shkollimin e fëmijëve tanë, sidomos me shkollimin e vajzave shqiptare.

Vendimet e marrura nga pleqtë në kullë u bënë realitet.

SHKOLLARET E PARA TË TREVËS SONË

SALIJE HALIT BUJUPI - HOXHA



Salije Halit Bujupi

U lind më 27.05. 1937 në Arllat të Drenicës. Ishte koha kur jo vetëm në Drenicë femra shqiptare konsiderohej “kafshatë e dreqit”. Kanuni kishte helmuar e vrarë çdo liri të femrës shqiptare. Ajo identifikohet me djallin, me të keqen dhe me kobin.

Mirëpo, falë dritëmendjes së babës Halit Bujupi, njeri i fjalës dhe i Zotit, njeri që dinte rëndësinë e librit dhe të

shkollës shqipe, njeri që kishte hetuar qëllimin djallëzor të armikut shekullor, pushtetit të Serbisë, se shkollimi i shqiptarëve, sidomos shkollimi i femrës shqiptare - drenicare, ishte një garanci e shkurtimit të jetës së tij në troje etnike dardane, shkurtimit të sundimit të tij mbi popullin e Kosovës.

E paç dheun e lehtë, o baba Halit Bujupi, shembulli yt për shkollimin e femrës na bën krenar, të pasur, t'i hapim sytë, të të falënderojmë e të mos harrojmë kurrë deri sa ka dritë dielli mbi njerëzimin!

Ndër të parat dallëndyshe fluturim mbi qiellin e mjegulluar të Drenicës, ndër të parat lule që mbushën aromë të këndshme shkollën shqipe, vullnetet e dashurinë për jetën e librin shqip për nxënësit drenicarë, sidomos vajzat me pështjellak të Drenicës, që dinin vetëm: lepe-peqe, dhe liria e saj ishte e kafshuar dhe e helmuar nga gojë e pangopur e kanunit të maleve, vajzat e Halit Bujupit morën leje nga baba Halit, dhe u nisën rrugës së shkollimit shqip, udhës së shkronjave shqipe, udhës së dijes dhe të emancipimit.

Sa e kishte mbaruar shkollën fillore në Arllat, u nis në shkollimin e mesëm në Prizren. Kur e mbaron të mesmen, filloi punën si mësuese në vitin shkollor 1953/54, në Arllat, kurse që nga viti shkollor 1960/61 në Krajkovë.

KADIJE BAJRAM BUJUPI - PEÇANI



Kadije Bajram Bujupi

Kadije Bujupi u lind më 08.02.1938, në Arllat të Denicës.

Si mësuese filloi të punojë në vitin shkollor 1952/53, së pari në Carrallukë, pastaj në Dragash dhe në Zanqisht.

Babë Bajrami kishte dëshmuar se ishte njeri që dinte ç'është feja, Zoti, por dinte edhe peshën që ka shkolla shqipe për shqiptarët, veçmas për femrat drenicare. Dhe, babë Bajrami shembi terrin e kanunit që ditën e natën i kërcënohej vajzës së saj me ndëshkim të rëndë, me terrin e syve dhe me peçen e zezë për fytyrë të ferexhesë, por, jo, jo, bre, kot e keni, gjallë është baba Bajrami, ai nuk ha mishin

e fatin e dritën e syve të bimës së gjakut, se nuk është soj mace. Të lumtë burrë Drenice, shembullin tënd prej babai të mirë e vizionar do ta kemi denbabaden si mostër për ecjen e brezave dhe të arsimit shqip.

Po ti, moj mësuesja Kadie, Motërmadhja jonë, mësuese pishtare, ti Lule dhe dallëndyshe Drenice, kush është më e pasur se Ti, kush është më krenare se Ti, kush është më e gëzueshme sot se Ti, sot kur Udha e Shkronjave Shqipe, kënga dhe fjala jote, ligjërimi shqip dhe porosia Juaj dhënë sa e sa brezave shkollarë të djemve dhe vajzave shqiptare, nuk ishte as më pak as më shumë se sa Udha e Lirisë, Luftëtarja trimërisht fytafyt me terrin dhe sundimin e territ që shekuj solli raca e shën Savës në Kosovë. Luftën e fituat edhe Ju. Edhe Ju ishit mësuese shqiptare, ishit çlirimtare, ishin trimëresha si Shota vetë, si Xhevë Lladrovci, Ju ishit dhe jeni motra të komandantit legjendar Adem Jashari, Ju ishit dhe jeni dallëndyshe të UÇK-së.

HATIXHE HALIT BUJUPI - SYLAJ



Hatixhe Halit Bujupi

Hatixhja ishte motra e Salijes. Një motmot ishte më e re se motra Salije. Zoti e deshi e këto vajza u lindën në djepin e babë Halitit, një burri e një shqiptari të fjalës e të dijes, një burri që perëndia ia kishte kthjelluar mendjen dhe kishte hetuar qëllimin e pushtuesit shekullor të racës së shën Savës, se shkolla për shqiptarët, sidomos për femrat, ishte një katastrofë dhe një kob për pushtetin e Sorranisë.

O burrë, o babë, o shqiptar i madh, ti Halit Bujupi, ti nderove Zotin dhe Tokën, nderove djepin dhe gruan tënde, nderove fenë dhe Atdhenë.

Ti luftëtar dhe fitimtar mbi kanunin e maleve, që mugëtirë e zi e më zi mbushi jetën e femrës shqiptare,

sidomos të femrës drenicare, ti tregetar dhe historian, ti njeri i fesë dhe i kombit, duke nderuar femrën, vajzat tua, nderove femrën shqiptare gjithandej ku flitet e këndohet shqip, gjithandej ku lindet dhe jetohet shqip, ku gëzohesh e vdes shqip!

Hatixhja u lind më 09.03.1938, në Arllat të Drenicës.

Shkollën fillore e mbaroi në Arllat, të mesmen në Prizren.

Si mësuese filloi punën në vitin shkollor 1952/53, në Arllat, pastaj, mësuesja tepër e nderuar, një Lule erëkëndëse në kopshtin e shkollës shqipe, një Ajkunë dhe një Tringë shqiptare që nam e dije e dritë e shpirt e zemër i dha rinisë shqiptare, fëmijëve të Drenicës, bimës së djepit të kësaj toke të lashtë dardane, që sa e sa herë u la me gjak për drejtësi, për dritë, për nderin, për diellin, për Atdheun deri më 17 shkurt 2008, kur kënga e motrave mësuese, të vajzave të babë Halit Bujupit, Udha e Shkronjave shqipe që mësuesja i derdhi para shkollarëve e shkollareve drenicare, bashkë me qindra trima e trimëresha të gjakut të Shotë Galicës, me heroizmin e sakrificën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që pati fatin, me gjak e pushkë çlirimtare të sjell madhështi në historinë e popullit të Kosovës, krenari e lavdi: Lirinë dhe pavarësinë, shtetin e lirë të Republikës së Kosovës.

Edhe Ti, moj mësuese Hatixhe, me motrën Salije, dhe të gjitha vajzat e tjera nga Drenica, që ndoqën rrugën tuaj të Diellit, me bekimin e të Madhit e të Gjithëfuqishmit Zotit, me sakrificë e shembull të rrallë që latë Ju në historikun e shkollës shqipe në Drenicë, ishit në ballë të frontit për çlirimin e Kosovës, ishit luftëtare, shembull i një beteje

tepër të vështirë në luftë me terrin e paditurisë, në luftë me kanunin e maleve, në luftë me djallin e quajtur Sorrani dhe, fituat, ja, motrat e mia, Ju korret fitore shkëlqimtare me të vetmen armë:

DITRURINË E SHKOLLËS SHQIPE!

Po, motra, Ju ishit mësuese, ishit prijatare të frontit të luftës çlirimtare, Ju ishit Dielli i Diturisë, nëpër dritën e saj ne pamë shtigjet e lirisë, nëpër dritaret e saj ne pamë se ishim rob, nëpër derën e saj pamë shtigjet nëpër të cilat fitohej liria, pavarësia, shteti dhe Republika e Kosovës.

Fjala juaj në shkollën shqipe u bë top e pushkë! Buzëqeshjet dhe vullnetet tuaja u bënë forcë e trimëri për brezat e shkollarëve që Ju u dhatë dije, porosi e amanet.

Mësuese Hatixhja në vitin shkollor 1954/55 punoi në fshatin Kizharekë, në vitin shkollor 1955/56 punoi mësuese në Kamaran, në vitin shkollor 1960/61 punoi prapë në shkollën e vendlindjes, në Arllat,

Kurse në vitin shkollor 1965/66 punoi mësuese në Glllogoc, sot Drenas.

Ju motra, vajza të babë Halitit, ju mësuese pishtare drenicare motra të Hamëz dhe Adem Jasharit, Ju krenaria e Drenicës, ju nëna që lindët dhe rritët djem e vajza ushtarë çlirimtare të UÇK-së, sikur Ju, mësuesja Hatixhe Sylaj, Nënëmadhja e Dr. Shkëlzenit të UÇK-së, vërtet latë pas vetes shkëlqimin e historisë së arsimit shqip, krenarinë e profesionit të mësuesisë, dhe porosinë brezave:

Pa punë e luftë nuk fitohen: as dituria, as liria!

Këto tri vasha shkollare nga Arllati heqnin të zitë e ullirit nga gojëkëqinjte dhe mendjet primitive të njerëzve, duke rrëzuar mbi jetën dhe udhën e shkollës shqipe nëpër të cilën ishin nisur ato, iftare dhe thashethemnaja, qyfyre e hajgare të helmatisura, duke u thënë, pos tjerash se ato vajza të veshura me fustane e me flokë të prera ishin bërë “shkina!”, se ato vajza po ia marrin fytyrën popullit, se ato paskan ndërruar fenë, pa ditur se gojë e tilla nuk kishin të drejtë dhe gabonin tepër rëndë. Gjithë thashethemnat e fyerjet në adresë të tyre përballuan dhe i shemben duke i hedhur në kokërr të shpinës, që në ditën e parë kur hynë me buzëqeshje mësueset e para shqiptare nga Drenica në klasën me nxënës shqiptarë, mësueset shqiptare.

Eeee, sa rroba të magjishme gëzimi e krenarie veshi atëherë katundi i Arllatit për të pritur mësueset shqiptare në shkollën shqipe. Secila gojë rridhte mjaltë, secila zemër i përngjante një ore zvicerane që rrihte me ritëm, secili sy i banorëve të Drenicës ishte bërë një yll, bebëzat e të cilit ishin ngulitur në bukurinë dhe shkëlqesinë e mësuesve të para drenicare, që në një mëngjes të shtatorit, të veshura siç vishet pranvera me lloj-lloj lulësh të erëkëndshme, rrugëve të fshatit mësyn shkollën shqipe, ku me gëzim, siç e pret syri dritën, siç e pret natyra pranverën, siç gëzohet nëna duke i dhënë gji foshnjës mbi djep, siç i gëzohet toka shiut, siç i gëzohet zemra nektarit të gëzimit, hyrën në oborr të shkollës së fshatit. Ç’ të shohësh? Ç’ ndodhte atë ditë në katundin e Arllatit? Ç’ kishte Drenica që ushtonte nga gëzimi e derdhte krenari gjithandej anëve të horizontit, nga i erdhën një mijë e njëqind fyerje e minimizime nga gojë të shtrigë, se Drenica ishte një burg me shekuj për femrën,

ishte një kopsht ku kultivoheshin primitivizmi dhe padituria, kanuni dhe feja, që dita-dita hanë shpirtin e zemrën, dinjitetin e jetën e femrës drenicare.

O kot e patën dhe e kanë gojëkëqinjtë që ditë e natë hedhin gur e dru, hedhin fyerje e pështymë e qyfyre mbi traditën dhe dinjitetin, mbi moralin e historinë, mbi burrërinë e trimërinë e mashkullit e femrës nga Drenica, se shpirti i drenicarit është shpirt i popullit, është roje e Atdheut, është sinonim i burrërisë dhe i trimërisë, i luftës me shekuj kundër racës së shën Savës që me shekuj piu gjakun e nderin e hëngri lëkurën e popullit të Kosovës, por Drenicës i mbeti ashti, varret dhe tradita e luftës dhe e shpirtit luftarak, i mbeti në sofër copa më e ëmbël e bukës e nderit dhe e jetës: Krisma!

Kemi lindur me Krismën. Kemi bërë cacat e para me të nëpër tokën e blozuar shekuj nga shtjellat e Shpresës së robit. Kemi hëngër të njëjtën bukë me kokrra kripe të Shpresës, të njëjtën lugë druri e kemi pasur në sofër. Secilën kafshatë e kemi ngjye me Krismë. Me ushtimën e saj kemi përcjellë dasma dhe lindje të reja. Ajo na takoi me ushtimën e maleve, me amanetin e stërgjyshërve dhe ashtin ilir. Na erdhi në ndihmë sa herë ishim ngushtë. Dimrat i bënte verë, verat i shndërronte në male. Zhdavariste retë sterrë, dukej syri magjik i princit të dritës, dilte ylberi pas shiut, ndërronte rrobat natyra.

Me Krismë kemi larë besën e thyer, me të e kemi kthyer nderin e humbur. Me të kemi rrëzuar e përzënë nga trojet etnike mbretër e filistinë, që thithnin si me pambuk gjakun e robit. Me Krismën kemi mbrojtur e ruajtur grigjat

e berrave, me të kemi goditur hasmin e hajdutin, me të kemi larë fytyrë, kemi ça bllokada lukuni demonësh mizorë.

Kështu i pati thënë sy me sy udbashit serb mësuesi dhe atdhetari Shaban Murat Jashari, kur ligjet e shtetit fantazmë të shokut Tito e kishin arrestuar mësuesin shqiptar në orën e mësimit, tek ishte duke ua recituar fëmijëve në klasë vargjet e Fishtës dhe të Mjedjes.

Ishte viti 1948 kur në Arllat ndërtohet një lokal i ri shkollor me katër mësonjëtoje, dy zyre dhe një bodrum. Ky lokal i ri shkollor ishte përkrahur dhe ndihmuar ditën e natën nga aktivisti i atëhershëm, Sinan Demir Bujupi, ish - nxënës i brezit të parë të vitit shkollor 1928/29. Shkolla e re u ndërtua në lokacionin ku është edhe sot, në lagjen Bujupi, sepse, nuk ishte lejuar ndërtimi i shkollës në lagjen e Xhamisë.

Vendi ku ndodhet sot ndërtesa e shkollës fillore sot e kësaj dite quhet “Mrizet”.

Punët e mjeshtërisë i kryen vetë banorët e Arllatit e të Gjurgjicës, atëherë, nga mjeshtër në zë, siç ishin: Musli Misin Morina, kryemjeshtër, Halit Hajdin Bujupi, Ramadan Bytyçi, Asllan Salih Bujupi, Brahim Tahir Bujupi, Hazir Xhemë Bujupi, Musli Sylë Bujupi, Brahim Sejdi Bujupi, Nush Osman Krasniqi, Lah Hazir Bujupi etj.

Sapo u ndërtua objekti i shkollës së re shumëçka ndryshoi për të mirë: Përditë e më tepër rritej interesimi i fëmijëve të kësaj ane që të ndjekin shkollimin shqip, por ende intensiteti i këtij interesimi i femrës për shkollim nuk kishte arritur pikën kulmore, ani pse rezultatet flisnin për të mirë.

Në orën e parë të mësimit mësueset shqiptare drenicë bënë orë historie. Nuk shpjeguan gjë me gojë para nxënësve. Nuk u shpjeguan, sepse, nuk kishte nevojë t'u shfletonin historinë e hidhur të popullit, të vendlindjes, por edhe të Kosovës. Jo, sepse, në fytyrën e fëmijëve shkollarë mësueset lexonin muajt e ditët, lexonin motet dhe shekujt nën robëri, kjo shtrigë që erdhi bashkë me drejtin e zi, me gabelët nga Karpatet bashkë me arushën, që hante pesë-gjashtë shkopinj shpinës e turinjve po nuk kërcente duke qëndruar në këmbët e prapme dhe duke hungëruar tmerrshëm kinse dinte për të emetuar valle njerëzish. Tërë këto kërcime arusha e magjupëve i bënte ata që e shikonin t'i jepnin asaj arushe një copë buke misri, apo një copë djathi.

Ora e parë e mësimit, vitin shkollor 1952/53, kur mësueset e para të Drenicës filluan punën edukativo-arsimore, solli krejt diçka tjetër, solli diçka të re, të paharrueshme që kurrë nuk u harrua nga kujtesa e nxënësve. Mësueset drenicë u recituan shkollarëve ca vargje shqip tepër interesante, që më vonë, nuk i patën mësuar vetëm ata nxënës, por ato vargje i mësuan përmendësh baballarët, nënat, gjyshër e gjyshe gjithandej Drenicës:

KOSOVËS SË ROBNUEME

*Moj Kosovë, Kosova trime
Pse vajton me kaq idhnime
Pse s'i ndan sytë nga Epiri
Prej nga njeriut i shkon hiri
Kah t' ka shkue trimnia e parë
Me fatosat tu shqiptarë
Që nuk dinin çka ashtë tuta
Nuk i trembte pushka, huta*

*Çka t'ka gjet Kosovë e shkretë
Që po të shoh me fytyrë të zbehtë
Pse mjerisht një thunër e vështirë
Rri tue t' shkelë pa kurnji mëshirë
E shkretnueme Kosovë trime
Ke mbet vetëm ndër mjerime
Anekand sot të ndihet gjama
Vaj e zija e lot e ndama*

*Jo, jo - nuk za besë
Që Kosova kështu do mbes
Kam uzdajë në Zot të qiellit
Se një ditë rrezet e diellit
Kanë me shkrep, kanë me ngjallue
Kanë me shndritë e me trimnue
Kosovari ka me gëzue
Ka me gëzue kosovari
Që ndër dej ka gjak shqiptari.*

Pirro Floçi

Dalja e mësueseve të para pati jehonë të madhe jo vetëm në Drenicë. Ishin këto dallëndyshet e para që paralajmëruan stinë mbushur edhe më me shumë, Lule, edhe më me shumë Afërdita shqiptare. Nuk pati zemër që nuk u gëzua, nuk pati shpirt që nuk u mori lakmi mësueseve të para drenicë.

Kanuni i maleve ishte plagosur dhe ishte rrëzuar në kokërr të shpinës midis Drenice, vendi që deri atëherë për dikush-dikushët të sojit të djallit, ishte vend i qyqeve dhe i kukuvajkave, ishte vend i territ mendjes dhe i skamjes së skajshme, vend me një popull mikpritës dhe bujar, por me popull të shtypur e të ndrydhur me themër të Akilit.

Me këtë rast po e theksojmë një kuriozitet tepër interesant që e solli mësuesi Islam Gashi:

Gjatë provimit në lëndën e muzikës Islami para mësuesit këndoi këtë këngë:

*Këndo o zogu i malit
Këndo se jam mërzit
Eja këqyri mësuesit
Janë tue luejt me shpirt!*

Oda shqiptare ishte vendi i urtisë, i kuvendeve të burrave, i marrjes së vendimeve, i lidhjes së besës, ishte një shkollë ku mësohej e zhvillohej historia e kombit.

Rapsodi Liman Zariqi këndonte këngën:

*Mos kjaj ti Nish, Tregur, Podgor
Mos kjaj Yskyp, Dibër, Janinë
Mos kjaj Ohrid, Prevezë, Prishtinë
Mos kjaj Gjakovë, Ipek, Prisren
Se Skënderbeun tash mbret e kem.*

*Besa mori nanë, pa ty s'mund të rrimë
Do shesim gja e të gjallë
Të luftojmë për lirinë.*

Mbaj ndërmend kur në shkollën tonë patëm përgatitur recitalin “Luajtë e Kosovës”:

*Shkoni e thoni Shemsi Pashës
Mjera nana që t'ka le
Për Prekazin që e dogje
Veç mos dalsh kurrë mbi dhe!*

Udhën e shkronjave shqipe, udhën e dijes e të ardhmërisë, pas këtyre tri mësueseve drenicare e ndoqën edhe shumë të tjera, mirëpo, respekti dhe nami i këtyre vajzave të para që thyen akullin e primitivizmit ekstrem të një vetëdijeje të kohës së gurit, por sot e kësaj dite nuk u shlye, nuk u harrua as që do të harrohet kurrë shembulli i këtyre tri femrave drenicare, pishtare te arsimit shqip, përderisa ka dritë dielli mbi kryet e njerëzimit.

Përveç punës dhe veprimtarisë edukativo-arsimore në shkollë, tri mësueset jepnin kontribut të çmuar në

shfletimin dhe tregimin e historisë, të padrejtësive dhe robërisë që kishte sjell në troje etnike dardane pushtuesi i huaj, duke i treguar popullit shqiptar të vërtetën. Ja disa nga faktet dhe argumentet që tri mësueset e reja drenicare shpesh i tregonin popullit:

Pikësëpari mësueset i tregonin popullit qartë e shpluet për: Programi i likuidimit të shqiptarëve 1920, Programi i Çubriloviqit 1937, Programi i Ivo Andriqit 1937, Programi i Moleviqit 1941, Programi i Drazha Mihajloviqit 1942, Elaborati i dytë i Çubriloviqit 1944 dhe 1945, Programi për shpërnguljen masive të shqiptarëve 1950, Memorandumi i Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve 1986, Programi i depërtimit në det 1981, Elaborati i shtetëzimit të pronave të serbëve (kolonëve) në Kosovë 1986, Ligji për vendosjen e të huajve 1865, Ligji për viset e populluara 1880, Dekreti I për kolonizimin e Kosovës 20 shkurt 1914, Dekreti II për kolonizimin e Kosovës 1920, Ligji për kolonizimin e viseve jugore 1945, Ligji për ndarjen e banesave dhe rikolonizimin e ri të Kosovës 1995

Pastaj:

Rishqyrtimi i kadastrit të tokave në 714 fshatra shqiptare në rajonin e Nishit dhe të Toplicës në kohën e Kongresit të Berlinit gjatë luftërave Ballkanike 1912-1915, me të cilën dyndje, me dhunë u likuiduan apo u vranë 150 mijë njerëz të pafajshëm, duke mos harruar as spastrimin e mbi 4000 rrënjësve nga këto territore ilire.

Spastrimi i shqiptarëve nga trojet etnike dardane për në Turqi. Shtëpitë e veta i braktisën (i lanë shkret) afro 500 mijë njerëz.

Ndërmjet dy luftërave botërore (1919-1941) për në shkretëtirat e Anadollit nga Kosova u përzunë 255.878 shqiptarë!

Shi nga ky shembull i mirë i tri mësueseve, tri bijave të shtrenjta të popullit, në ecje të kohës është mbajtur e gjallë një batutë për tri dallëndyshet e para të shkronjave shqipe, të shkollës e të diturisë, tri shtegtare në udhën atdhetare kombëtare të rilindësve të paharrueshëm gjithandej trojeve etnike shqiptare:

Vërtet, sot njihet e shihet treni me binarë elektromagnetikë, mirëpo, lavdin dhe nderimin, uratën dhe përgëzimin, jehonën dhe lakminë që pati zbulimi i makinës me avull i Xhems Watit, zor që mund t'ia tejkalojë ndonjë zbulim tjetër sot o nesër.

Shkolla e re në truallin e Mrizeve nuk shërbente vetëm për diturinë e fëmijëve, por aty mësueset hapen kurse kundër analfabetizmit, me të cilin rast shkronjat shqipe mësonin edhe nënat, gjyshërit, por edhe ata të rritur që u kishte ikur mundësia për të mësuar së paku alfabetin shqip.

Për hatër të brezave të rinj nuk duhet harruar të vërtetën kur pushteti sllavo-komunist i shokut Tito, me kërkesën e Aleksandër Rankoviçit, në lokalet e po kësaj shkolle zbatuan aksionin makabër dhe barbar me emrin Aksioni i Mbledhjes së Armëve. Ç'është e drejta, një

aksion i tillë barbar zbatohet vetëm në Kosovë e Metohi, pra, vetëm te populli shqiptar, për disa arsye:

E para: Futja e frikës të popullata shqiptare dhe krijimi i mundësive që shqiptarët ta respektojnë dhe ta pranojnë pushtetin e Serbisë për të vetin, ta pranojnë Serbinë si shtet dhe si republikë të veten.

E dyta: të prishet disponimi, të shuhet dëshira dhe motivi i fëmijëve shqiptarë për shkollimin e mëtutjeshëm shqip, por të binden shqiptarët se Kosova është tokë e “shenjtë” e Serbisë dhe ata të kërkojnë strehim tjetërkund, pra të shpërngulen nga trojet etnike. Pati edhe raste të shpërnguljes me dhunë të familjeve shqiptare, sidomos të atyre familjeve atdhetare e patriotike, nga shtëpitë dhe trojet e veta stërgjyshore.

Në aksionin gjakatar dhe absurd të kinse mbledhjes së armëve, u rrahën deri në vdekje, u fryn e u përndoqën anëtarët e familjeve më të zëshme dhe bujare, të familjeve të moralshme e atdhetare për çështje kombëtare. Ende janë të freskëta batërditë dhe plagët nga barbaritë e udbashëve jo vetëm serbë, por edhe shqipfolës, që munduan e burgosën, por pati raste edhe të vrasjeve mizore me hekur e dru të burrave e djemve më të dashur të popullit.

Disa vite më herët para zbatimit të Aksionit të Mbledhjes së Armëve në Kosovë e Metohi, pushteti serbë, i lejuar nga kryekomunisti dhe vazali stalinian, shoku Tito, fillon aksionin për ndjekjen dhe përndjekjen e atyre pak mësuesve shqiptarë, që tek sa kishin dalë mësues për të mbjellë farën e dijes dhe të shkronjave shqipe gjithandej Kosovës. Shtriga vrastare me emrin UDB, pastaj KGB-ja, KOS-i i APJ-së, u hodhën egërsisht pas “gjuajtjes së

shtrigave”, pas gjurmëve dhe punës edukativo-arsimore të mësuesve shqiptarë.

“Ilaçi” i dorës së parë për t’u shëruar (shpëtuar) nga thonjtë e UDB-s, ishte thirrja e udbashëve dhe e argatëve të mjerë shqipfolës që mësuesit shqiptarë të Drenicës e Kosovës të hedhin një këmbë në shkollë, një në pushtetin e Serbisë.

Helmin e kësaj thirrjeje e përjetuan keq ish-nxënësit e brezit të parë shkollës laike (ne gjuhen e okupatorit) nga Arllati: Shaip Hajdin Bujupi, i cili, nga se nuk pranoi kurrsesi të bashkëpunojë me pushtetin e huaj, me UDB-n, largohet fare nga procesi edukativo-arsimor, ishte mësues në Siçevë të Klinës, me fajësinë: I mungojnë cilësitë moralo-politike! Shaipi kurë më s’u kthye në arsim, as pas rënies së turpshme të Rankoviqit. Të theksojmë se mësuesin Shaip Bujupi e kishin fajësuar udbashët se ishte bashkëpunëtor i Sigurimit të Enver Hoxhës!

Zeqë A. Dobruna ishte larguar nga shkolla shqipe, si i papërshtatshëm për arsim, por më vonë i njëjti pati gjetur punë në administratën e komunës së Gllogocit.

Rexhep Sh.Bujupi, gjithashtu është larguar nga detyra e mësuesit.

Kurse, Brahim Lah Gashi, mësues në Kaçanik, arrestohet dhe dënohet me pushkatim, për t’i mbajtur 11 vjet burg të rëndë në Goli Otok, e shumë e shumë të tjerë.

Pas rënies së xhelatit serb, Aleksandër Rankoviqit, çdo gjë shqiptare, sidomos arsimi shqip filloi të frymojë më lirshëm dhe t’i shërojë gjithë ato blana (shenja plagësh) që ia kishte bërë UDB-a e Sorranisë e sojit të shën Savës.

Shtohet numri i mësuesve, numri i mësonjëtove dhe numri i nxënësve, sidomos rritet numri i vajzave që vijonin shkollën.

Shkollës së vjetër iu shtua një aneks, që u ndërtua me hua popullore.

Ishin vitet e 60-ta, ku të gjitha shkollat e Kosovës emërtohen me emra heronjesh, ndërsa shkolla e Arllatit emërtohet “Emin Duraku”.

Në vitin 1964 filloi ndërtimi i një aneksi të ri për shkollën në Arllat, ndërtohen edhe tri mësonjëtove, një kthinë e një korridor.

Punët ndërtimore i kreu Selman Zariqi.

Kur më 1968 u organizuan protesta gjithëpopullore në Kosovë, rinia dhe banorët e Arllatit ishin gëzuar tepër shumë. Sidomos arsimitarët dhe nxënësit.

Më kujtohet mua (n.b.) kur xha Musa nga Gjergjica ne oden e burrave për demonstratat e 1968-tës pati thënë:

- Këto (demonstrata) janë lojë zogjsh me sokolin!

Por koha e dëshmoi të kundërtën.

Kërkesat e demonstruesve ishin të qarta:

Republikë, Kushtetutë, ja me hatër ja me luftë!

Pastaj zëshëm u kërkua liria e Flamurit të kombit, për të cilin kishte ra mizorisht në burgun e Prishtinës mësuesi dhe poeti drenicar nga Sankoci i Drenicës - Flamurasi, Fazli Greiçevci.

Shkolla fillore e Arllatit u mbush me një frymë të re patriotike. Filloi ardhja e shtypit nga Shqipëria dhe shpërndahej shpesh edhe falas. Në tërë Kosovën. Vijnë grupet e profesorëve nga Universiteti i Tiranës, për të

shpërndar dituri përmes studentëve të Universitetit të Prishtinës gjithandej në Kosovë, grupet e ndryshme kulturo-artistike etj.

Nxënës dhe arsimtarë të Shkollës Fillore të Arllatit ditën e natën punonin atdhetarisht: përgatitnin drama e pjesë teatrore, mbanin orë letrare dhe koncerte me këngë e valle popullore.

Në vitin 1963 nxënësit e arsimtarët e Arllatit shfaqën “Hasan Aga dhe Çika Patureshë”, kurse në vitin 1968, kolektivi i shkollës - paralele e ndarë në Tërpezë shfaqti pjesën teatrore “Skënderbeu” me rastin e pesëqindvjetorit të vdekjes së legjendës shqiptare Gjergj Kastriotit - Skënderbeut. Pastaj në vitin 1970 nxënës e arsimtarë shfaqën pjesën teatrore “Ajshja”, në vitin 1971 shfaqën dramën “Halili e Hajria”.

Të gjitha këto aktivitete qëllim kishin bashkimin e mendjes e dëshirave e fuqisë për një bashkim kombëtar kundër shtypjes e tiranisë serbo-çetnike në Kosovë.

Kurse në fillim të vitit 1981 filluan përgatitjet për pjesën teatrale “Toka e jonë” të autorit Kolë Jakova, por Revolucioni i 1981 i ndërpreu ato.

Në gara sportive e besa edhe të diturisë nxënësit e Arllatit shpesh zunë vendet e para dhe u nderuan me mirënjohje nga Kuvendi Komunal i Glllogocit, e më gjërë.

Pranvera e viti 1981 Shkollën Fillore të Arllatit e gjeti në një shkallë tepër të lartë të ngritjes së vetëdijes kombëtare, mësimore e patriotike.

Nxënësit dhe arsimtarët e Arllatit ishin në ballë të demonstratave - Revolucionit historik për çështje kombëtare.

Arsimtarët, nxënësit dhe prindërit e tyre u ndeshën fytafyt me politikën hegjemoniste e titiste, me politikën sllavo-komuniste dhe gllabëruese të pushtetarëve të Beogradit. Hiç më mirë kjo frymë patriotike dhe revolucionare e Arllatit dhe e Drenicës nuk u nda me pushtetarët a atëhershëm shqiptarë, të cilët ashiqare ia mbanin krahun pushtuesit serb, shtypjes dhe tiranisë, shtypjes me dhunë e plumb të këtyre demonstratave gjithëpopullore në Kosovë.

Po, ishin të veçanta mbledhjet e pushtetarëve, aktivistëve sahanlëpirës dhe qyqarë që mbanin krahun e dhunës e të robërisë, sidomos me kolektivin dhe me banorët e Arllatit, ku kërkonin publikisht të dënoheshin me ligj e burg fëmijët dhe mësuesit tanë, të keqtrajtoheshin e të vriteshin shpirtrat dhe grushtet e ngrehur lart e më lart deri të hundët e Evropës dhe të OKB-së, të cilët nuk kërkonin pushtimin e tokave dhe vendeve të huaja, por kërkonin liri e demokraci, kërkonin trojet etnike të lira, kërkonin barazi e drejtësi edhe për shqiptarët e Kosovës së aneksuar me dhunë ushtarake nga Serbia.

Nuk i dënonin arsimtarët nxënësit e tyre atdhetarë dhe të mirë, nuk ngrehnin gishtin e dënimit dhe të krimit mbi gjakun e lëkurën dhe jetën e shumë nxënësve dhe arsimtarëve, studentëve dhe prindërve që kishin ra dëshmorë të kombit para tytave të tankeve dhe të pushkëve të pushtuesit serbo-çetnik, fytafyt kishin qeruar hesapet bilbilmirët me korbat e zinj nga Beogradi dhe Jugosllavia diskriminuese komuniste titiste e staliniste.

- Ku ke parë, o biri i shkinës që shqiponja ha krimba, ha mut e shurrë, jo, jo, gabim, gabim e ke, zog shkinë,

shqiponja e maleve shqiptare ha trutë e sytë e pi gjakun e pushtuesit dhe robëruesit, ia rjep lëkurën e shtyp eshtrat sojit të dinozaurëve, sepse, egërsia karpatiane shkel ia kishte shtratin e pragun, dhunuar e përdhunuar dinjitetin e moralin e shqiptarit zot përmbi zot në troje etnike ilire.

Baba ta dënojë djalin atdhetar? Nëna ta dënojë vajzën patriote dhe sokoleshë malesh, që fytafyt u rrok me bishën e çakërdisur sllavo-çetnike? Mësuesi ta dënojë me burgim nxënësin dhe abetaren shqipe?

Prindi ta dënojë arsimtarin, duke i thënë se ti, o arsimtar yni qenkësh terrorist dhe në rrugë të gabuar?

- Jo, jo, - thanë arllatasit, ne nuk e shtimë dreqin e huaj në gji e ta dënojmë e urrejmë gjakun e guximin e heroizmin e bijve e bijave tona.

Kot e ke, o racë e Car Dushanit, shqiptari ka lindur me pushkë e do vdes me pushkë në dorë në luftë për liri e nder e dinjitet kombëtar!

Shih, tash, lexues i nderuar, në mbledhjen e marsit 1981, kolektivi i shkollës në emër të të gjithë nxënësve e prindërve të Arllatit u dërgoj mbështetje demonstruesve dhe kërkuesve të lirisë, siç u pati dërguar edhe minatorëve në horizontin e nëntë në “Trepçë”.

Në mëngjesin e së premtes të datës 03.04.1981, mësuesi Naim Bujupi, u thotë nxënësve të rreshtuar para shkollës:

- *Pushteti jugosllav edhe në dritën e syve tuaj e sheh rrezikun.*

Komiteti i Lidhjes Komuniste të Kosovës dha urdhër të mbyllet shkolla jonë derisa të largohet rreziku nga

melodia e thirrjeve të rinisë së Kosovës, popullit të saj, për liri, Kushtetutë, Republikë!

Ndërsa këtë ditë në libër të kujdestarisë së ditës e shpallë Ditë Zie.

Mësuesi Ismet Sopi, me një u tha nxënësve me zë të lartë:

- Tradhtarëve duhet t'ua ndalim turrin me gur e therra.

Mësuesi Jakup Krasniqi (sot kryetar i Parlamentit të Kosovës) para gjyqit thotë:

Unë jam shqiptar, nuk jam jugosllav!

Shaban Shala (sot gjeneral i TMK-së):

- Për të gjallë jo më jeta jonë në robëri dhe nën çizmen e shkaut!

Erdhi vendim i prerë i Komitetit të LK të Gllgocit për kolektivin e shkollës sonë:

- Të merren të gjitha masat e duhura më rigorozë për të gjithë ata arsimtarë dhe nxënës, të cilët janë bashkangjitur në demonstratat e marsit e prillit 1981. Ndaj bartësve të tillë të distancohen të gjithë njëzë, dhe pasojnë arrestimet e burgosjet për vepër penale, qortim i fundit, largim nga puna, lëçitje.

U bë një pështjellim i madh. Kurrësi arsimtarët nuk pranonin fajësimin e njëri-tjetrit, mësuesit ndaj nxënësit e nxënësit ndaj mësuesit, prindit ndaj fëmijës dhe fëmijës ndaj prindit.

Shkollën Fillore të Arllatit sejmenët e Komitetit të LK-së e kishin shpallë çerdhe të nacionalizmit dhe të irredentizmit, si rreziku më i madh për tërë territorin e Kosovës.

Mbase ndokush, nën presionin dhe kërcënimin e sejmenëve të Beogradit, mund edhe ti ketë dënuar Demonstratat e 81-shës, por kjo edhe mund ti falet sepse: *Aty ku tmerri është i madh, hipokrizia paraqitet si art.*

Nga Komiteti Komunal i LK-së erdhi lajmi se paskan ardhur nga Amerika dy çanta me miliona dollarë për të rrëzuar pushtetin e Jugosllavisë, për ta shkatërruar atë krejtësisht dhe Kosova për t'iu bashkangjitur Shqipërisë. Një çantë me dollarë pushteti jugosllav e paska zbuluar në Klinë (Kosovë), kurse çanta tjetër me dollarë amerikanë qenka fshehur diku në fshatin e Arllatit, ndoshta, hiç larg mendsh nuk është, ajo çantë mund të jetë fshehur diku në ndonjë qoshe të klasave të kësaj shkolle.

Kjo ishte arma e politikës së Titos, e argatëve qyqarë të tij, të mashtruar për disa dinarë të dhirë jugosllavë, kjo ishte mençuria e deledashëve shqipfolës, kuadër mjeranë dhe qyqarë të shtetit dhe politikës së Jugosllavisë titiste-staliniste.

Nga kjo politikë e politikanëve shqipfolës të mjerë, të cilët tashmë i urrenin edhe fëmijët e familja e tyre, i konsideronin të vdekur dhe të turpshëm, sepse, u arrestuan dhe u keqtrajtuuan u fajësuan dhe u gjykuan me mbi dhjetë vjet burgim, jo vetëm arsimitarë të Shkollës Fillore të Arllatit, por edhe nxënës të fillores e ish-punëtorë.

Për vepër penale u dënuan:

- *Jakup Krasniqi u dënua me 15 vjet burgim, ish-punëtor i Shkollës Filllore të Arllatit,*
- *Bajram Gashi, 15 vjet burgim, ish-nxënës i kësaj shkolle*
- *Ismet Sopi, dënohet më 14 vjet burgim, - arsimtar i kësaj shkolle*
- *Naim Bujupi dënohet më 12 vjet burgim, - arsimtar i kësaj shkolle*
- *Sherif Krasniqi dënohet 10 vjet burgim, - arsimtar i kësaj shkolle*
- *Pajazit Krasniqi më 9 vjet burgim, - arsimtar i kësaj shkolle*
- *Shaban Shala dënohet 7 vjet burgim, ish-nxënës i kësaj shkolle*
- *Alush Thaçi dënohet më 13 vjet burgim, ish-nxënës i kësaj shkolle*
- *Fadil Brahim Bujupi, i dënuar me 8 vite burgim, ish-nxënës i kësaj shkolle.*
- *Ferat Shala më 1 vit burgim, ish-nxënës i kësaj shkolle.*

Për vepër kundërvajtje u dënuan:

- *Fidaim Berisha, Graboc, punëtor i Shkollës Filllore në Arllat*
- *Agim I. Krasniqi, Negroc*
- *Mehdi S. Morina, Arllat*
- *Haki H. Berisha, Kamaran*
- *Ferat M. Bujupi, Arllat*
- *Xhevat B. Gashi, Llapushnik*

- *Hysni L. Bujupi, Arllat, ish nxënës i shkollës së Arllatit me punë në Slloveni, ku edhe dënohet me burg.*

U morën në pyetje:

- *Abedin S. Bujupi, nxënës i kl. III*
- *Xhemë M. Bujupi, nxënës - absurd: Kinse në bankën e tyre u gjetën të shkruara dy shkronja: K.R.*

Nga procesi edukativo-arsimor u largua:

- *Miradije Amërllah Gashi.*

Arsimtarët, ata që mbetën në punë, gati të gjithë, u transferuan në vende të tjera pune në shkolla të tjera të komunës së Gllogocit.

Në Arllat e gjithandej në Drenicë u hetua mungesa e theksuar e miellit, mungonin preparatet higjienike, u bë lëçitja e familjeve, djemtë e të cilave gjendeshin të burgosur.

Vetë shoku Ali Shukria, ish-funksionar i lartë i Jugosllavisë, kishte urdhëruar që shqiptarëve t'u ndalohej furnizimi me miell, kripë, ujë...

Kishte harruar shoku Ali porosinë e Brahim Ramë Bllacës:

- *Kujdes, shqiptarët e Kosovës janë si topi: sa më shumë t'i sjellësh, aq lart e më lart kërcen!*

Gazetarja Nadire Vllasi, në një gazetë shkruante:

- *Shqiptarët edhe dasmat i kanë nacionaliste!*

Nëpër shkolla të Drenicës u larguan drejtorët legjitimë dhe në vendin e tyre të punës Komiteti Komunal i LK-së i solli njerëzit që lakmonin për një karrierë drejtori.

Në Shkollën Fillore të Arllatit caktohen për të udhëhequr me procesin edukativo-arsimor tre aktivistë të Komitetit Komunal të LK-së.

Interesant kishte ndodhur me mësuesin veteran Islam Gashi, në orën e muzikës, në të cilën duhej mësuar nxënësve një këngë me motive nga patriotizmi jugosllav, por mësuesi veteran bën mrekulli:

Na vrt-mrta
Trta-mrta
Vrta-mrta-trta!
Mrta-trta-vrta

Me Vrt-mrta e trta-vrta, nuk mbahet i pushtuar një popull i tërë.

Njësitë mësimore të shumë lëndëve ishin hequr nga plan-programi i mësimit, sidomos ishin herr njësitë e lëndëve shoqërore e historike, gjeografi, histori, dituri natyre e shoqërie, muzikë, vizatim, e të tjera.

Çdo gjë shqiptare e arsimit shqip ishte nën llupën e aktivistëve të Komitetit Komunal të LK-së. Ata ishin mbidrejtore, ekzekutorë të lloj-lloj masave disiplinore për arsimtarë, përjashtim nga puna për një fjalë goje, përjashtoheshin nxënësit për hiçgjë, për mbajtje të rrobave ku ishte qëndisur shqiponja dykrenare përjashtoheshin nxënësi menjëherë dhe masa e masa të tjera disiplinore...

Serbia i bie në qafë Kosovës. Do ta ther në fyt, t'ia pi gjakun dhe ta shndërrojë në një gëzhojë të pavlerë. Sidomos halë në sy kishte arsimin shqip. Në sy bote i përzë nxënësit shqiptarë nga shkollat e veta që populli me djersë ua kishte ndërtuar.

Armata e arsimdhënësve: Pushka top t'u bëftë, o Beograd!

Nxënësit shqiptarë: Duam librin shqip! Duam dije! Duam Kosovën!....

Burgjet e mbushura me të rinj nga Kosova:

- Pushka e arsimit shqip është dritë e ardhmërisë, është fanar që na bën dritë Ne, nëpër qeli të ftohta akull!

Serbia në sybote rrënoi me tanke e dhunë ushtarake-policore edhe atë trohë Kushtetute që e pati Kosova.

Arsimi shqip vetëfinancohet, kurse arsimtarë e nxënës shndërrohen në qëndresë dhe thirrje të zëshme për mobilizim gjithpopullor:

O sot o kurrë!

Viti 1997. Në shkollën e Arllatit Sokol Krasniqi e solli eprorin e UÇK-së, Agim Çela. Në kabinetin e shkollës i tuboi dhe foli me ata arsimtarë që duheshin.

Pas mbarimit të vitit shkollor 1997/ 98, Shkolla fillore e Arllatit ishte shndërruar në shkollë ushtarake. Gjashtëdhjetë e kater djem të zgjedhur Ishin ndarë në dy togje. Me ta punonin:

- Afrim Shaip Bujupi, epror për stërvitje dhe rreshtim. Afrimi ishte komandant i Togut të Parë.

- Fadil Fazli Gashi, epror i armatimit të lehtë, komandant i togut të Dytë.
- Hafir Bytyçi ishte epror për armatim të rëndë.
- Agim Bujupi ishte caktuar për ushtrime dhe për ndihmë të parë.
- Ramë Buja ishte ligjërues politik.
- Sherif dhe Zymer Krasniqi për logjistikë ushtarake.
- Naim Bujupi kryente detyrën e drejtorit të shkollës ushtarake, duke u përkujdesur për mirëvajtjen e të gjitha punëve të lartpërmendura, që të mos hetohej kjo veprimtari ushtarake e UÇK-së.
- Isa Krasniqi dhe Fadil Bujupi, bënë emetimin e filmave ushtarakë strategjikë me kinoprojektues të metrazhit të shkurtër.
- Sinan Shala nga Krojkova mjeshtër i përpunimit të drurit në uzinën e tij private punoj 64 shtretër nga druri për nevoja ushtarake.

Herë pas herë shkollën dhe këto veprimtari ushtarake i vizitonte, Jakup Krasniqi, Shaban Shala, Ferat Shala, Emin Hasan Bujupi, Shaban A. Bujupi etj.

Të gjithë ata djem që mbaruan me sukses ushtrimet ushtarake morën rrugëtimin për në Shqipëri për t'u pajisur me armë, municion, dhe uniforma.

Shkolla fillore e Arllatit gjatë gjithë luftës së UÇK-së ishte grumbulluese dhe përcjellëse e kamionëve me ushqim, municion dhe gjera të tjera, që vinin nga Theranda, Prizreni, Gjakova, Malisheva, Rahoveci, Mamusha e të

tjera, duke u bërë të mundur kapërcimin e asfaltit në udhëkryqin e Arllatit dhe të njëjtit të dërgojnë ushqim në drejtim të Krojkovës, Likocit, Skënderajt dhe gjithandej ku luftohej kundër armikut barbar serb. Vëzhgimin e rrugës e bënte Enver Lutfi Bujupi dhe u printe automjeteve për në këto territore.

DËSHMORËT E KOMBIT DHE MARTIRËT NGA ARLLATI

ABEDIN Salih BUJUPI
(25.12. 1971-10.11.1998)



Abedin S. Bujupi

U lind në Arllat të Drenasit, më 25.12.1971. Tetëvjeçaren e kreu në vendlindje, kurse të mesmen në Drenas. Në shkollën e mesme takohet me shokë e shoqe të brumosura me dashurinë për liri, me të cilët, sa herë ishte nevoja, shpërndante afishe, materiale sekrete të Ilegales, në

Prizren, Arllat, Drenas, Kamaran. Llapushnik, Sankoc, e tjerë.

Shokët e tij të ngushtë: Muharrem Xhemali, Sami Gashi, Fehmi Gashi, Sylejman Bytyçi, Florim Krasniqi, e të tjerë.

Më 1991 shkon në Austri për të punuar, kur kthehet në vendlindje tashmë policia serbe e kishte në defter emrin e tij, dhe ik prapë e shkon në Gjermani. Atje takohet me veprimtarë dhe atdhetarë të devotshëm që ishin strehuar përkohësisht nga pushteti sllavo-çetnik: Fehmi dhe Xhevë Lladroci, Ramiz Lladroci, Agim M. Bujupi, dhe Fitimin nga Krojkova, me Luanin nga Kravasaria, e të tjerë.

Më 1998 Abedini kthehet në Kosovë dhe më 15.05.1998 e jep betimin e ushtarit çlirimtar të UÇK-së, në Negroc. Pjesëmarrës aktiv në luftimet në Grykën e Llapushnikut, në Krojmir, në Qyqavicë, e tjerë.

Bashkëpunonte me dr. Fadil Bekën, Driton Gashin, Hyra Istogun, Hivzi Bajraktarin, Gani Kastratin, Shaban Dragën, Naim Malokun, Tahir Sinanin, me komandant Obrijën, Fadil Gashin, axhën e tij, Hysni Bujupi, dhe vjehrrin, Halit Istogun, e tjerë.

Abedini moto kishte fjalët e Fehmi Lladrocit:

- Mixho, Kosova kërkon djemtë dhe vajzat e saj, mos rrini të struktur por bashkohuni në luftën çlirimtare për liri!

Në rrugën nga Negroci për në Arllat hetohet nga forcat serbe, të cilët i vihen pas me makina ushtarake dhe në Negroc, Abedini del nga makina e tij, zbraz një rafal automatiku në pizgauerin e armikut ku pas, nje lufte fyta-fyt me shkije bie heroikisht Abedini për të mos vdekur kurrë.

Në valët e radios, më dhjetë nëntor 1998, femra lele me emrin Hajrie Spikerica, jep lajmin se në Negroc të Glllogovcit u vra terroristi shqiptar, Abedin S. Bujupi, u vranë dy policë serb, ndërsa u plagosën disa policë të tjerë.

***KËNGË PËR DËSHMORIN E KOMBIT
ABEDIN BUJUPI***

*UÇK-ja ngjitet malit
Janë ushtarë t'Adem Jasharit.
Abedini flet prej shpatit
Kjo s'është tokë e Car Dushanit.*

*Shkrihet bora, po nxeh dielli
Kthehet Fehmiu dhe Abedini
- Këtu kam djepin, kam Drenicën
Këtu kam gjuhën, kam Donikën.*

*Këqyr sahatin, ora dymbëdhjetë
Në jesh shqiptar, eja me vdekë!
Ushton Gryka, thërret Fatosi
Zjarri gjarprin nis e sosi...*

*- Hallall gjini, i thotë nana
Abedinit me shtatë zemra.
Herë në Fatos, herë në Krujë
- Jam shqiptar, s'kam gjak me ujë.*

*Ditën, natën me armë në dorë
Abedini trim malësor
Dhjetë nëntor nëndhjetetë
Lufton Dini bën gajret.*

*Po i del bishës ballë për ballë:
- Kadalë, bishë se jam shqiptar!
Jam shqiptar, s'ta kam tutën
Për liri s'e ndali luftën.*

*Bini trima besa-besë
Çlirimtarë të UÇK-së.
Merrja anën, vëlla, o Pëllumb
Në lule të ballit jepi plumb.*

*Çonja nënës një amanet
Thuaj Dini ra me vdekë
Ti Donikë për babë mos qaj
Se lirinë e ligështon vaji.*


*- Lumja nana që të ka ty
Jo pa gjak nuk ka liri!
Shkolla shqipe, ku ke le
Ka marrë emrin: Promete!*

*Në këtë shkollë mëson Donika
Dini i vogël, shumë petrira
Tek perëndon, tek lind dielli
Dëshmor kombi Abedini!*

Autor: Riza Greiçevci

ARBEN Avdullah SHALA

(15.04.1983-11.05.1999)



Arben A. Shala

U lind në Gjergjicë, shkollën tetëvjeçare e mbaroi në Arllat, të mesmen në Drenas.

Më 1998, me moshatarët e tij hyri në radhët e UÇK-së. Përkujdesej për informim, bartje të ushqimit etj. Duke bartur shokët e plagosur bie në mina të forcave armike serbe. Aty plagoset bashkë me Fejzë Bujupin. Arbeni i Ri nga plagët e marra në trupin e njomë ndërron jetë me fjalët: Gjaku im u bëftë dritë lirie për popullin tim.

Trupi i dëshmorit sugar i UÇK-së i qetë pushon në varrezat e dëshmorëve të Kombit në Palac të Skenderajt.

BEDRI Veli SHALA

(02.06.1969-10.08. 01998)



Bedri V. Shala

U lind në Negroc më 02.06.1969, shkollën fillore e mbaroi në Arllat, të mesmen në Gllogoc.

Nga familja trashëgon, bujarinë, mikëpritjen, atdhedashurinë e trimërinë. E tërë familja ishin në listën kundër Jugosllavisë.

Çdo herë ishte në përkrahje të vëllaut më të madh Shabanit. E donte pa masë Shabanin dhe thoshte këtë shtëpi do t'ia ndërtojë bacit Shaban. Dhe vërtet në atë shtëpi tani jeton Shabani me familjen e tij.

Bedriu çdo herë ishte në ballë të demonstratave e protestave (1981-1989). Ai ishte trim, patriot dhe i guximshëm. Për shkak të ndjekjeve të përhershme nga

milicia serbe, ai detyrohet të ik në ekzil, dhe së bashku me vllaun Elmiun shkon në Holandë. Kontaktet më të shumta, pos shokëve të tjerë, i mban me Bekim Berishën (Aben). Në mars të 1998-ës Bedriu me të vllaun Elmiun dhe shumë shokë të tjerë këthehet në Kosovë për t'iu bashkangjitur rradhëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Fillimisht vendosen në Açarevë, në shtëpinë e Sylejman Selimit.

Bedriu shpeshherë thoshte: jam i lumtur që ma solli fati të luftoj për lirinë e popullit tim, për Kosovën time.

Bedriu luftën nuk e bëri vetem në Drenicë, por ai u angazhua shumë edhe në Dukagjin, veçmas në Junik, Jabllanicë, Gllogjan etj.

Ishte komandant (epëror) për stërvitjen e të rinjëve, për luftë kundër armikut dhe për çdo mëngjes në shkollën ushtarake bënte ngritjen e flamurit. Si me shaka u thoshte shokëve ushtarë: Erdha nga Drenica të ngris flamurin në Dukagjin! Mandej Bedriu në Tropojë kishte thënë: Nëse është shkruar nga Zoti, vdekja ime, dëshira ime është dhe gjithënjë ka qenë të vdes duke luftuar ballë për ballë me armikun barbar shkja.

Pas luftimeve tre javore rradhazi, dhe humbjeve të mëdha të armikut, në njerëz e makineri luftarake, nëpër lagjet e fshatit Junik, Bedriu plagoset rëndë në momentin kur i afrohet një tanksi.

Në mëngjesin e datës 11.08.1998 Bedriu bie për të mos vdekur kurrë, duke iu lënë shokëve amanet që lufta të vazhdohet gjer në çlirimin përfundimtar të Kosovës.

Trupi i dëshmorit pushon i qetë në Varrezat e Dëshmorëve në Palac të Skenderajt.

BEDRI Habib GASHI
(28.08.1967-05.06.1999)



Bedri H. Gashi

U lind me 28.08.1967, në Arllat. Shkollën fillore e kreu në vendë lindje, kurse të mesmen në Glllogoc, në ato vite kur zhvilloheshin demonstrata të rinisë dhe popullit të Kosovës kundër regjimit të pushtuesit serb.

Merr rrugën e mërgimit për ta zbutur gjendjen e vështirë ekonomike, punoi në Kroaci. Ishte ndjekur e përndjekur nga policia serbe, por nuk dorëzohej. Në Kroaci bie në kontakt me përfaqësuesit “Vendlindja thërret” ku nga Spliti niseshin të rinj e burra për në Shqipëri e pastaj në Kosovë. Gjendet në Bajram Curr dhe mori për sipër 15 ushtarë të UÇK-së, duke u nisur për në frontin e luftës, nën

komandimin e komandant Rrahim Bekteshit, Brigada 126 “Hasi”, operacioni “Shigjeta”.

Gjatë luftimeve te rrepta që u zhvilluan në Pashtrik, me 05.06.1999 në luftë fytyfyt me armikun bie heroikisht sypatremburi, trim i madh Bedri Gashi. Trupi i tij me nderime ushtarake varroset ne Bjeshkët e pashtrikut, dhe në vitin 2000, trupi i tij tërhiqet nga atje dhe rivarroset ne Varrezat e Dëshmorëve në Kleçkë.

BASHKIM Mustafë BUJUPI

(15.11.1973-2004)



Bashkim Bujupi

U lind me datën 15.11.1973 në Arllat. Shkollën Fillore Bashkimi e kreu në vendlindje, kurse të mesmen në Drenas. Studioi në Prishtinë. Punoi si mësues në Arllat-Bytyq.

Më 1995 merr udhën e mërgimit, në Gjermani, për t'u kthyer në Shqipëri më 11.02.1999, ku i bashkohet aradhave të UÇK-së.

Në fillim të qershorit të vitit 1999, në kufirin artificial Kosovë-Shqipëri zhvillohen luftime të rrepta në mes të UÇK-së dhe forcave kriminale serbe. Gjatë lufimeve Bashkimi plagoset dhe dërgohet për shërim në Shqipëri,

dhe pas shërimit kthehet përsëri në pikën roje e UÇK-së deri në mbarim të luftës.

Pas mbarimit të luftës, Bashkimi i bashkangjitet bashkëmoshatarëve të tij në klubin futbollistik të fshatit. Në vitin 2005 aksidentalisht humb jetën.

Shokët e tij në shenj kujtimi për veteranin e luftës së UÇK-së, Klubit futbollistik të fshatit i vënë emrin “Bashkim Bujupi”.

FEHMI Minush MORINA

(08.05.1952-11.04.1999)



Fehmi M. Morina

U lind në Gjergjicë, shkollën tetëvjeçare e mbaroi në Arllat, të mesmen në Kievë, ndërsa Shkollën e Lartë Pedagogjike, dega Gjuhë Shqipe dhe Leterësi në Prizren.

Fillon me punë në vitin shkollor 1980/81 në Arllat.


Në prill të vitit 1981 bie ndesh me politikën Jugosllave dhe si masë ndëshkuese e transferojnë në shkollën e Llapushnikut, ku punon deri në vitin 1999.

Gjatë luftës së UÇK-së strehohët me familje në Negroc. Në pranverën e vitit 1999, pas luftimeve të njëpasnjëshme ndërmjet UÇK-së dhe forcave kriminale

serbe, forcat serbe futen në Negroc. Në shenj hakmarrjeje me datën 11.04.1999, kriminelet serbë bëjnë masakrimin e mbi 70 shqiptarëve civil të pa mbrojtur, në mesin e tyre vritet edhe mësuesi Fehmi. Trupi i tij pushon i qetë në varrezat e Dëshmorëve dhe Martirëve në Negroc.

GËZIM Haxhi MORINA

(16.01.1976-16.04.1999)



Gëzim H. Gashi

Gëzimi u lind në Arllat - Gjergjicë të Glllogocit, ku mbaroi tetëvjeçaren, kurse të mesmen në Glllogoc. Shquhej për urti, sinqeritet dhe pjekuri në mes moshatarëve të tij.

Si i ri merr rrugën e kurbetit në Gjermani.

Kur kriza pushka çlirimtare e UÇK-së, Gëzimi me tërë familjen e tij u radhitën në krahun e luftës për liri. Bile edhe shtëpia e tij ishte shtëpi e UÇK-së. Nëna e Gëzimit, Zarife Morina, i dha bukë e ujë e nderim të pashembullt Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e deshi UÇK-n me shpirt e zemër, aq sa e deshi edhe djalin e vet, Gëzimin.

Tre ushtarë i dha UÇK-së nënë Zarifja: Gëzimin dhe dy djem të tjerë.


Pas kthimit nga mërgimi, Gëzimi, në Kalimash jep betimin para flamurit të kombit si ushtar i UÇK-së dhe luftëtar për liri.

Radhitet në frontin e Koshares, në Brigadën 138 “Agim Ramadani”, me komandimin e Hysen Berishës.

Më 16 prill 1999, në betejën e fortë ndërmjet UÇK-së dhe forcave armike serbe, në Shkozet të Molliqit, ra dëshmor i kombit Gëzim Haxhi Morina për të mos vdekur kurrë.

HAMIT Jetish GASHI

(1923-26.03.1999)



Hamit Jetish Gashi

Shkollën fillore në gjuhën serbo-kroate e kreu në Arllat. Mu pse dinte shkrim-lexim Hamiti dha kontribut të çmuar në luftimin e analfabetizmit në masa popullore.

Më 1951 mbaron kursin pedagogjik në Pejë dhe caktohet mësues në Llazicë, punoi edhe në Sferkë të Gashit, në Llashki Drenoc, Tërpezë, Krojkovë, Llapushnik dhe në Arllat.

Ishte drejtor i shkollës në Arllat, në vitet 1966-69

Në mars të 1999-ës qëllon të miku i tij, në Gllogoc, të Ahmet Qorri.

Derisa turma e të zënëve robër marshonte kushedi për ku, Hamiti në ballë të kolonës grindej me policët e paramilitarët serbë, duke i sharë dhe fyer ashtu siç e meriton shkau. Vritet nga dora barbare serbe më 26.03.1999.

ISMAIL Dan BYTYÇI

(01.11.1954-04.08.1998)



Ismail D. Bytyçi

Shkollën tetëvjeçare e kreu në Arllat, të mesmen e mbaroi në Prizren, kurse Shkollën e Lartë Pedagogjike drejtimi Politeknikë, e mbaroi në Prishtinë.

Një kohë punoi në Inspektoratin e Glllogocit. Kur pushteti kriminal serb e mori dhunshëm autonominë e Kosovës bëri edhe pushtimin e administratës lokale në Glllogoc. Ismaili dëbohet nga puna dhe me familje vazhdon jetën në Suharekë. Me që ishte mësues me profesion fillon punën në Shkollën fillore të Reshtanit dhe atë të Dulës.

Me formimin e njësiteve të UÇK-së në Suharekë kyçet edhe Ismaili.

Në prill të vitit 1998, bie në pritë të forcave armike serbe në Bukosh, pas një rezistence titanike të UÇK-së, plumbi gjakatar i armikut e godet në gjoks Ismailin dhe kështu pushon së rrahuri zemra e një luftetari trim, një mësuesi të zellshëm dhe punëtor.

LULËZIM Metë BUJUPI

(08.12.1961-1998)



Lulëzim M. Bujupi

Lulëzimi tetëvjeçaren e kreu në vendlindje, shkollën e mesme në Drenas, kurse Shkollën e Lartë Pedagogjike në Gjakovë. Sa ishte student policisë serbe i bie në sy aktiviteti i tij patriotik. Arrestohet disa ditë. Pastaj punon arsimtar në SHF “Bashkimi” në Drenas.

Në luftime zihet rob nga forcat armike serbe në shtëpinë e tij. Aty e masakrojnë barbarët serb dhe trupi i tij u gjet në Varrezat e Qytetit të Prishtinës në Dragodan - Arbëri. Rivarrosët me nderime të larta në varrezat e fshatit Arllat.

MENTOR Naim GASHI

(26.04.1983-18.04.1999)



Mentor N.Gashi

U lind në Llapushnik të Drenasit. Pas ofensivës së gushtit tërhiqet në malet e Berishës dhe që andej, bashkë me familjen kalon në Llap. Atje ndjek mësimet në shkollën e mesme. Kur fillon lufta çlirimtare e UÇK-së, Mentori lë shtëpinë dhe familjen në Llap dhe kthehet në Drenicë duke u inkuadruar pikërisht në Grykën e Llapushnikut.

Ishte ushtari më i ri i brigadës “Ismet Jashari-Kumanova”.

Synimi i armikut serb për të depërtuar në Male të Berishës ku ishin strehuar masa të mëdha popullore, nuk pati sukses.

Në luftime tepër të ashpra ndërmjet forcave ushtarake të UÇK-së dhe të atyre të armikut, ra Dëshmor i Kombit, Mentor Gashi, në moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare.

Ushtari sugar bëri një ndarje fizike, por kujtimi për të do të mbetet për jetë të jetëve i gjallë.

Trupi i Mentorit pushon në Varrezat e Dëshmorëve në Kleçkë.

MEHDI Nebih BYTYÇI

(11.11.1963-16.04.1999)



Mehdi N. Bytyçi

Shkollën fillore e kreu në Tërpezë, të mesmen në Glllogoc, kurse Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë.

Profesionin e mësuesisë e filloi në shkollën fillore “Hasan Prishtina” në Tërpezë, e pastaj punoi edhe në Arllat.

Shkëputet nga arsimi shqip dhe merr rrugën e kurbetit në Gjermani, por kur mori udhë të lirisë UÇK-ja, Mehdiu kthehet menjëherë në vendlindje dhe i bashkëngjitet çlirimit të Kosovës.

Si nxënës i Gjinnazit në Glllogoc mori pjesë në demonstratat e vitit 1981, bashkë me Elmije Plakiçin, Enver Dugollin, Naim Bujupin, Ismet Sopin, e tjerë.

Angazhohet në Njësitin “Pëllumbi”, pastaj në Njësitin “Çeliku”. U shqua si trim dhe i shkathtë për luftë. Emërohet komandant i Togut për Arllat me seli te Bytyçët.

Në asfaltin mes dy pozicioneve serbe, me shokë sulmojnë forcat armike që udhtonin me një makinë, ku ishin dy punëtorë të lartë të sigurimit serb. Vrasin dy armiqë serbë dhe e asgjësojnë makinën e tyre.

Këtë aksion të suksesshëm e kreu bashkë me Sylejman Bytyçin, Sami Gashin, Osman Krasniqin dhe me Arben Gashin.

Të mllfosur dhe të tronditur nga heroizmi i çlirimtarëve të UÇK-së, forcat armike serbe ndërmarrin një sulm të fuqishëm në Bytyç në afërsi rreth 150 metra. Në këtë betejë heroikisht dhe si trimat bien dëshmorë Mehdi Bytyçi dhe Sylejman Bytyçi.

Në vendin e sulmit mbi forcat serbe, është ngritur lapidari që çdo herë reflekton rreze lirie.

MEHDI Sylë MORINA
(02.02.1952-26.09.1998)



Mehdi S. Morina

U lind me 02.02.1951 ne fshatin Gjergjicë. Shkollën fillore e kreu në Arllat, të mesmen në Drenas dhe regjistrohet në fakultetin e Makinerisë në Prishtinë. Punoj mesues i matematikës në Shkollën Fillore të Arllatit. Më 1981 bie ndesh me politikën jugosllave dhe dënohet me dy muaj burg për kundërvajtje.

Me datën 26.09.1998, forcat armike serbe duke u terhequr nga vendpozicionet e tyre arrijnë deri në fshatin Golluboc të Malishevës. I ndajnë burrat nga popullata dhe kryejnë veprën më barbare duke masakruar 14 civil të pambrojtur, në mesin e të cilëve ishte edhe mësuesi Mehdi

S.Morina. Shpeton vetem një nga ta sa për të dëshmuar për krimin dhe vendin ku janë varrosur trupat e pa jetë të tyre. Më datën 05.09.1999, trupi i pa jetë i mësuesit Mehdi rivarrosset në varrezat e Dëshmorëve dhe Martirëve në Negroc.

MILAZIM Rrahim GASHI

(20.06.1958-21.06.1999)



Milazim Rr. Gashi

Milazimi u lind në Llapushnik. Shkollën tetëvjeçare e mbaroi në Arllat, kurse të mesmen në Kievë.

Punoi në Kooperativën Bujqësore në Kamaran.

Ishte rapsod i rrallë. Me këngën patriotike shqipe frymëzoi shpirtin e lënduar të popullit, rriti shpresat për udhën e lirisë dhe sikur i mobilizoi me melodinë e këngës së tij.

Ishte anëtar i SHKA “Shotë Galica” të Glllogocit.

Gjatë luftës çlirimtare të UÇK-së, në territorin që e mbulonte Brigada 121 “Kumanova”, me të vëllanë Qazimin, me këngë kreshnike e patriotike hapi shtigjet të

historisë e të trimërisë së popullit shqiptar nëpër ecje të shekujve. Me këngë folklorike e melodi shqipëtare ai ngriti moralin e ushtarëve të UÇK-së, por edhe të popullit, shtoi guximin dhe sikur ua tregoi gjuhën e historisë e të trimërisë, së pa luftë e gjak, pa sakrificë e vetëflim nuk shporret nga trojet etnike stërgjyshore gjarpri helmues i Karpateve.

Pas fitores madhështore të UÇK-së, në oborrin e shkollës së Arllatit kishin mbetur shumë mina dhe predha të pa eksploduara. U ndërmor aksioni për deminim dhe Milazimi vullnetarisht i bashkangjitet ekipit të deminerëve të UÇK-së dhe të KFOR-it. Gjatë deminimit dhe grumbullimit të minave, aksidentalisht eksplodon grumbulli prej 54 minave, ku Milazimit së bashku me dy ushtarë të UÇK-së dhe dy të KFOR-it, ua shuajnë jetën.

OSMAN Adem KRASNIQI

(06.02.1966-21.06.1999)



Osman A. Krasniqi

U lind në Llapushnik. Shkollën fillore e kreu në Kamaran, kurse të mesmen në Glllogoc. Punoi në Ferronikël. Sapo u formua Njësiti i UÇK-së “Pëllumbi”, Osmani, iu bashkangjit këtij Njësiti dhe bashkë me shokë, më 03.06.1998 nisët për në Shqipëri për t’u armatosur.

Kufirin shqiptaro-shqiptar forcat armike serbe e kishin minuar dhe aty Osmani plagoset rëndë. Të theksojmë se bashkë me ushtarët e UÇK-së ishte edhe një gazetar norvegjez, i cili, plagoset po ashtu rëndë. Pasi i jepet ndihma nga shokët, Osmani i shpëton më të keqes dhe më 08.06.1998, kthehet në vendlindje. Menjëherë

mobilizohet në Grykën e Llapushnikut. Pastaj radhitet në Kompaninë e Berishës - Batalioni I “Ymer Alushani”, në Brigadën 121 “Kumanova”.

Aktiviteti i tij, shkathhtësia dhe trimëria ishte vënë re nga shokët dhe eprorët e UÇK-së: në Llapushnik, Bytyç, Arllat, dhe gjithandej ku këmba e tij shkeli.

Në granatimet serbo-çetnike, Osmanit i vritet nëna, plagosen i vëllai dhe motra.

Pas rënies së Mehdi Bytyçit, caktohet komandant togu në Bytyç. Pas mbarimit të luftës, duke bërë deminimin e territorit, bie në mina, më 21.06.1999, në oborrin e Shkollës fillore “Abedin Bujupi” të Arllatit.

Ndahet fizikisht nga ne nxënësit dhe arsimtarët e shkollës, por Osmani çdo herë, për jetë të jetëve, do të mbetet i gjallë.

Trupi i Dëshmorit pushon i qetë në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit në Kleçkë.

RAMADAN Emin BYTYÇI

(07.02.1964-18.04.1999)



Ramadan E. Bytyçi

Ramadani shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Glllogoc. Nga gjendja e vështirë ekonomike merr rrugën e kurbetit nëpër republikat e ish-Jugosllavisë.

Me të dalë publikisht UÇK-ja vjen e radhitet në Njësitin “Pëllumbi”. Mori pjesë në shumë beteja: në Grykë të Llapushnikut, Rahovec, në Grykën e Ramadanëve, e tjerë.

Beteja e tij më e suksesshme ishte më 26 e 27 prill 1999, që u zhvillua në shiritin e asfaltit në vendin e quajtur “Samërdan”.

Ishte komandant i Togut dhe çdo herë në ballë të aksioneve.

Në prill të vitit 1999 kalon në Brigadën 121 “Kumanova”, në cilësinë e zëvendëskomandantit të Kompanisë.

Në mars, Ramadani me shokë sulmon forcat armike serbe në Gjergjicë dhe atyre ua djeg disa makina, në vendin “Shavarina” të Arllatit. Ai hyn natën në pozicionet serbe, ua merr flamurin, ua ngushton rrethin e veprimit me mina të tyre. Kur forcat serbe e hetojnë se flamuri i tyre paska marrë flakë, duke vrapuar pas ushtarëve të UÇK-së, bien në mina të veta, dhe tërë ditën kishin bartur trupa të pajetë serbësh për në drejtim të Beogradit.

Më 18 prill 1999, nga forcat serbo-çetnike sulmohet Gradina e Llapushnikut. Armiku pëson humbje të mëdha në njerëz nga pushka dhe trimëria e Ramadanit, me shokë. Në atë betejë heroike kalojnë në përjetësi: Ramadan Bytyçi, Halim Bajraktari-Gllogoc, Islam Kastrati-Kizharekë, Mentor Morina-Kamaran, Mentor Gashi-Llapushnik, të gjithë tani dëshmorë të Kombit, ranë duke luftuar për mbrojtjen e mbi 100.000 banorëve që frymonin në projet e bjeshkës së Berishës nëpër tendet e najllonit. Gjaku i tyre u bë dritë lirie.

Tani trupi i Ramadanit pushon i qetë në Varrezat e Dëshmorëve dhe Martirëve në Palac të Skenderajt.

RRAHMAN Islam GASHI

(08.01.1938-26.07.1998)



Rahman I. Gashi

U lind në Llapushnik të Drenasit. Për shkak të kushteve të rënda ekonomike si shumë shqiptarë të tjerë edhe Rrahmani e merr rrugën e gurbetit, për të punuar, punëtor krahu në Slloveni, Kroaci etj. Kthehet në Kosovë, për të vazhduar jetën pranë familjes së tij.

Pas masakres që çetnikët serb bënë në Likashan dhe Qirez, fillon organizimi i rojes nëpër fshatra, një detyrë të tillë me mjaft syqeltësi dhe përgjegjësi e bënë edhe Rrahmani në fshatin e tij. Mandej me armën personale kyçet edhe në radhët e njësitit ushtarak “Pëllumbi”. Pas thyerjes së Grykës heroike të Llapushnikut, Rrahmani në luftë ballëpërballë me shokë bie heroikisht në vendin e quajtur “Madenet e Llapushnikut” me datën 26.07.1998.

SAMI Daut GASHI

(02.12.1972-21.06.1999)



Sami D. Gashi

U lind në Arllat me 02.12.1972, ku mbaroi edhe shkollën tetëvjeçare, kurse të mesmen në Glllogoc.

Ishte njëri ndër organizatorët protestave kundër pushtetit serbo-çetnik, shpërndarës i Alternativës dhe i trakteve, me përmbajtje “Kosova Republikë”.

Për këtë veprimtari patriotike u arrestua nga policia serbe.

Gjykata për kundërvajtje e dënoi me dhjetë ditë burgim.

Në korrik të vitit 1998 kreu ushtrimet ushtarake në objektin e shkollës së Arllatit, qe ne atë kohë ishte shndërruar në shkollë ushtarake. Po në këtë vit u bë pjesëtar i UÇK-ës, në njësitin ushtarak “Pëllumbi”. Shumëherë udhëtoi për Shqipëri për t’u pajisur me armatim.

Më 21 qershor 1999 ra dëshmor në Shkollën Filllore të Arllatit, duke bërë pastrimin e oborrit të shkollës nga minat dhe bombat kasetore.

Trupi i Dëshmorit pushon i qetë në Varrezat e Dëshmorëve në Kleçkë.

SYLEJMAN Xheladin BYTYÇI

(07.02.1973-16.04.1999)



Sylejman Xh. Bytyçi

Tetëvjeçaren Sylejmani e kreu në Arllat dhe Tërpezë, të mesmen në Glllogoc. Punoi në shkollën e vendlindjes.

Si shumë të tjerë, Sylejmani, në Shkollën e Arllatit mori mësimet ushtarake. Pas mbarimit edhe të stërvitjeve ushtarake merr rrugëtimin për në Shqipëri për armë, municion dhe uniforma. Pas kthimit nga Shqipëria radhitet në Njësitin “Pëllumbi”, pastaj në “Çeliku”.

Në fshatin Kleçkë, Sylejmani kryen prapë stërvitje ushtarake, në Njësitin e vëzhgimit “Arbëri”, me përkujdesjen komanduese të Tahir Sinanit. Ka marrë pjesë


në shumë beteja të UÇK-së, në Grykë të Llapushnikut, në Arllat, dhe ku ndihej nevoja.

Bashkë me shokët ushtarë të UÇK-së: Mehdi Bytyçin, Osman Krasniqin, Sami Gashin, të tre sot dëshmorë të kombit, me sukses kryen sulmin e armatosur kundër një makine policore-ushtarake serbe dhe vranë dy punëtorë të lartë të sigurimit serbë.

Më 16.04.1999, gjatë përleshjes, luftës fyta-fyt me forcat serbe në një largësi prej 150 metra, duke i shkaktuar humbje të mëdha armikut, bien heroikisht në fushën e nderit së bashku me Mehdiun.

Trupi i Sylejmanit pushon i qetë në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit në Kleçkë.

SYLË Jakup MORINA
(06.05.1968-26.07.1998)



Sylë J. Morina

Shkollën tetëvjeçare e mbaroi në Arllat. Në moshë të re mori udhën e kurbetit, punoi në Rijekë.

Kur në Kosovë u dha kushtrimi për liri, Sylë kthehet në vendlindje dhe i bashkëngjitet radhëve të Njësitit “Pëllumbi” në Fatos, ish-Negroc. Ushtari i zellshëm merr rrugën e gjatë për në Shqipëri për t’u armatosur. Ai merr pjesë në luftimet kundër forcave armike në Gjocaj të Junikut dhe aty bie dëshmor i kombit.

A VRITET FËMIJA?

A vriten pëllumbat? A shkelen lulet? A i ndahet drita syrit?

A i shteret qumështi gjirit? A vritet zogu duke kënduar?

A goditet zogu duke fluturuar? A i ndahet fëmia nënës?

A i shkoqet drita hënës? A shuhet drita e diellit?

A i hiqen kockat mishit? A pihet gjaku i fëmijës?

A hahet mishi i fëmijës?

E kemi parë me sytë tanë, jemi bindur, në fillim s'u kemi besuar syve tanë, por, ndodhi jo njëherë, shumë-shumë herë, raca e shën Savës, serbi gjakatar, nguli thikën në trup të foshnjës, ia preu qafën foshnjës, ia këputi fëmijës kokën, poq e fërgoi mish shqiptari ky serb barbari!

Dhe, doni dëshmi? Sa barë e dushk!

Lexoni e mësoni ç'zi bëri soji i shkinës mbi nxënësit e Arllatit: plumbi u ngul në mishin e 10 trupave të njomë të fëmijëve:

1. *Shkëlqim Rexhep Gashi, kl. I - Shkolla fillore në Arllat, i vrrarë nga forcat serbo-çetnike.*

U plagosën këta nxënës:

1. *Blerta Salih Bujupi, kl. II*
2. *Sefer Naser Bujupi, kl. I*
3. *Nazmi Alush Bujupi, kl. VIII*
4. *Adil Elmi Bytyçi, kl. V*
5. *Liridon Ramadan Gashi, kl. VI*
6. *Miftar Zymer Gashi, kl. VI*

7. *Bali Rifat Gashi kl. VIII*
8. *Gerta Bejzë Bytyçi, kl. VII*
9. *Besnik Gani Gashi, kl. VI - Llapushnik*
10. *Afërdita Dervish Gashi, kl. VIII Llapushnik*

ARMIKU RRËNOI GODINËN E SHKOLLËS SHQIPE

Lukunia barbare serbo-çetnike, pasi zbriti fitimtare e madhështore nga malet Ushtria Çlirimtare e Kosovës, iku me bisht nën këmbë, me turp e faqe të zezë nga kishte ardhur që nga viti 1919.

Mllef, urrejtja dhe humbja e luftës me UÇK-në e kishte egërsuar bishën karpatiane ballkanike edhe më tepër Serbinë, prandaj, me të përfunduar bombardimet nga miqtë tanë amerikanë dhe NATO-ja, ajo i kishte porositur forcat e veta humbëse me gishta në gojë që pas vetes ta djegin edhe tokën e lere më njerëzit, shtëpitë dhe gjithçka shihte syri i tyre.

Në Shkollën Fillore të Arllatit gjithçka ishte rrënuar.

*Kabinetet e mësimit ishin vjedhur dhe shkatërruar:
Kabineti i biologjisë më i miri në të gjitha shkollat e Kosovës.*

Kabineti i fizikës

Kabineti i muzikës

Kabineti i mbrojtjes

Uzina e mjeshtrit të shkollës

Biblioteka e shkollës, ku me përbuzje e mllef kishin rrënuar, shqyer e përdhosur librin shqip, gjithçka kishin pasur mundësi, vetëm muret e shkollës kishin mbetur, edhe ato, besa të përgjysmuara.

Edhe muzeun e shkollës e kishin shkatërruar barbarët serbë të çakërdisur e të sëmurë mendsh.

Inventari i shkollës ishte shkatërruar, zyrat ishin demoluar, vjedhur e përdhosur shkinisht.

Bustin e Emin Durakut, emrin e të cilit atëherë e mbante shkolla jonë, e gjetëm të përplasur diku në një përrua, te Kroj i Karanocit.

Një këso gjendjeje kaosi dhe mjerimi barbarie shtazarake ishin edhe paralelet e ndara në Bytyç dhe në Gjergjicë.

Të gjithë që të parët ishim kthyer në Arllat ishim ballë kësaj gjendjeje të shkollës. Ç'të bënim ne?

Isha drejtori i shkollës.

Thashë vetmevete:

- Eu, Zot: sa herë u ngritëm në qiell e sa herë ramë në tokë, kësaj radhe do të ngrihem për të mos rënë më kurrë!

Me stafin mësimdhënës u pajtuam që të nesërmen të bëjmë regjistrimin e nxënësve të shkollës, të shihet sa nxënës kemi sot, sa kanë vajtur matanë kufijve të Kosovës, sa kanë vdekur e sa kanë mbetur gjallë.

Nuk vonoi po ditën e parë të kthimit në vendlindje, në oborr të shkollës erdhën pjesëtarë të UÇK-së.

- Unë me shokët e mi ushtarë po bëjmë pastrimin e oborrit të shkollës, rrethinës së saj dhe rrënojave nga minat e mbetura të armikut serb! - tha Osman Krasniqi, komandant i Togut. Me komandantin u pajtuan edhe shokët e tij: Sami Gashi, komandant skuadre, pastaj Emini, Enveri, Hyseni, Agimi, Sefedini, Aliu, Faiku e të tjerë.

Pjesëtarëve të UÇK-së u erdhën në ndihmë edhe forca të KFOR-it anglez, batalioni "Gurka".

Duke hetuar dhe pastruar terrenin nga minat e mbetura nga armiku serb, pikërisht më 21 qershor 1999,

befasishëm shpërthyen 54 mina kasetore dhe jetën e humbën pesë veta:

Tre shqiptarë dhe dy pjesëtarë të KFOR-it.

Këta janë:

Osman Adem Krasniqi - UÇK,

Sami Daut Gashi - UÇK,

LT Gareth Evans - KFOR,

SSGT Balaram Rai - KFOR dhe

Milazim Rrahim Gashi - civil,

U plagos rëndë Hysen Gashi - UÇK.

Për përgatitjen e tri lokaleve shkollore na ndihmuan, organizatat humanitare nga Perëndimi, e bashkë me to ishte edhe një organizatë gjermane, “Diakonia work” përfaqësues Manfred Kuhle. Kjo organizatë humanitare bëri renovimin e lokaleve shkollore në Arllat, sipas projektit që bëri Muhamet F. Bujupi, ndërsa punët i kreu firma “Fatoni” me pronar Xhavit Bujupi.

Kishat e bashkuara norvegjeze ndihmuan në paralele të ndara në Bytyq dhe në Gjergjicë.

Pastaj OXFAM-i siguroi ujin e pijshëm në Bytyç dhe në Gjergjicë.

UNICEF-i Organizatë Ndërkombëtare e Fëmijëve siguroi inventarin për shkollën amë.

Firma ndërtimore “Cap Anamure” nga Gjermania siguroi materialin e ndërtimit të aneksit shkollor në Bytyç.

CDF-i me pjesëmarrje të prindërve bëri pagesën për mjeshtër të ndërtimit.

Shoqata holandeze “Shansi për fëmijët e Kosovës” në shkollë i solli 37.250,00 DM.

Këto mjete i solli përfaqsesi i kësaj organizate Ger Dekker, ku iniciatorë dhe ndërmjetësues ishte ish nxënësi i shkollës sonë, tani punëtor dhe me banim në Holandë z.Ragip Fazli Gashi. Me parat që ata i sollën u blenë:

1. Inventari shkollor komplet për dy paralelet e ndara në Bytyç dhe Gjergjicë.
2. Inventari për tri zyret e shkollës amë “Abedin Bujupi në Arllat”.
3. Radiofonia për shkollë (mjetet e zërimit).

Në shkollën amë u sigurua uji i pijës që u financua nga Banka Botërore me 5.920,00 euro, ndërsa fshati e siguroi gypin e ujit. Punët i kreu z.Xhavit Bujupi. Kurse burimin e ujit e fali Behram Jakup Gashi nga Llapushniku.

U përgatitën tri objekte për fillimin e mësimit, ku mësimi filloj me 02.08.1999 në objekte të renovuara dhe me inventar të ri.

Kuadri arsimor që punoi në shkollën fillore të Arllatit nga viti 1945-2006:

- Shyqri Palloshka - Gjakovë
- Hajdar Suti
- Fuad Astrazubi - Prizren
- Muharrem Gashi - Kievë
- Kapllan Bruçi - Shqipëri
- Shaqir Bujupi - Arllat
- Zeqir Robaj - Astrazub
- Rasim Bujupi - Arllat
- Rexhep Shaqir Bujupi - Arllat
- Feriz Krasniqi - Tërpezë

Osman Krasniqi - Drenoc
Salije H. Bujupi - Arllat
Hatixhe H. Bujupi - Arllat
Dan Kryeziu - Mleçan
Hamëz Z. Gashi - Qabiq
Hashim Janova - Sankoc
Salih H. Ktrasniqi - Negroc
Sadik M. Gashi - Llapushnik
Sahit Gashi - Arllat
Emin H. Syliqi - Kizharekë
Xhemë Krasniqi - Negroc
Islam Gashi - Arllat
Hamit Gashi - Arllat
Latif Gashi - Llapushnik
Isak Krasniqi - Negroc
Idriz Morina - Arllat
Sylejman Gashi - Llapushnik
Rashit Gashi - Arllat
Dushan K. Krstiq - Kamaran
Islam A. Krasniqi - Negroc
Tefik Morina - Arllat
Beqir Dobërdolani - Karraticë e Epërme
Tahir Ajazi - Sankoc
Zenel Sh. Kastrati - Nekoc
Elez Morina - Krojmir
Ramadan A. Krasniqi - Tërpezë
Alush Krasniqi - Prizren
Salih Hoti - Plavë
Islam H. Duraku - Burojë
Sejdi Duraku - Burojë

Milazim Krasniqi - Tërpezë
Ferat M. Bujupi - Arllat
Isuf Bajraktari - Kizharekë
Halil M. Dautaj - Kastërc
Liman Desku Berisha - Siqevë
Istref Desku - Siqevë
Adem Salihaj - Kuqishtë - Rugovë
Idriz M. Gashi - Llapushin
Bajram Muqolli - Zabel i Poshtëm
Isuf Shala - Kizharekë
Islam Abazi...
Liman Berisha - Ujëmirë
Rizah H. Bujupi - Arllat
Salih H. Krasniqi - Tërpezë
Ismail Krasniqi - Tërpezë
Salih Sh. Hoxhoviç - Hoqë
Xhemal Haxhialimetoviç - Bjello Pole - Mali i Zi
Hasan Sh. Bytyçi - Arllat
Mustafë M. Morina - Arllat
Osman A. Krasniqi - Negroc
Isa Gashi...
Ahmet S. Dobruna - Arllat
Sadri H. Karaxha - Akrashticë
Hafir B. Gashi - Llapushnik
Bajram B. Bogiqi - Llapushnik
Sadri A. Krasniqi - Negroc
Mehmet Bajraj - Isniq
Ali H. Haxhinitaj...
Boshko S. Dastaniq...
Miftar M. Hasani - Paklek

Nuredin S. Sahitaj - Shtrubullova
Tahir I. Morina - Gllabar
Radisav H. Anixhiq - Ivangrad
Idriz H. Ibriqi - Kamaran
Sinan I. Gashi - Arllat
Hasan S. Hoxha - Damanek
Mehdi B. Sylaj - Kizharekë
Miliana Babaviq - Konjuh - Mali i Zi
Ilaz B. Zogu - Novosellë
Deli I. Hoxha - Karraticë e Epërme
Milazim B. Bytyçi - Tërpezë
Murat S. Krasniqi - Tërpezë
Mehmet D. Krasniqi - Tërpezë
Elez B. Zogaj - Novosellë
Hazir S. Krasniqi - Tërpezë
Hatixhe F. Kaçamaku - Prizren
Selman R. Morina - Arllat
Murat H. Krasniqi - Tërpezë
Halil, B. Gashi - Llapushnik
Xhafer R. Osmani - Mitrovicë
Hysni A. Likaj - Sankoc
Ajet M. Elshani - Krojkovë
Halil Balaj - Karraticë e Epërme
Faik H. Krasniqi - Tërpezë
Sherif A. Krasniqi - Negroc
Bahti R. Nishori - Kamaran
Ylber R. Bujupi - Arllat
Bajram H. Bujupi - Arllat
Ajet R. Kelmendi - Lipë- Mitrovicë
Shefqet I. Heta - Glllogoc

Haxhi I. Zogaj - Llazicë
Nazmi H. Krasniqi - Tërpezë
Bahtie I. Bujupi - Arllat
Hafir M. Bujupi - Arllat
Naim Sh. Bujupi - Arllat
Mehmet S. Bytyçi - Arllat
Ferat D. Gashi - Llapushnik
Hafir I. Zogaj - Novosellë
Ymer K. Nishori - Kamaran
Ibrahim N. Krasniqi - Negroc
Zymer S. Jusufaj - Glllogoc
Xhevdet M. Krasniqi - Tërpezë
Rrustem H. Zogaj - Novosellë
Shefqet N. Gashi - Llapushnik
Ismet T. Ramaj - Mitrovicë
Nazmi Sh. Bujupi - Arllat
Fazli Xh. Krasniqi - Negroc
Ibrahim K. Nishori - Kamaran
Hysen I. Gjoshi - Sankoc
Ibush M. Musliu - Shtrubullojë
Bahtir B. Bahtiri - Vërmicë
Nafi S. Morina - Arllat
Avdi Z. Gashi - Llapushnik
Ajnishahe H. Gashi - Arllat
Hamit Z. Berisha - Llapushnik
Fadil T. Shala - Negroc
Osman I. Kuqi - Arllat
Hasan Z. Syliqi - Kizharekë
Rrustem H. Zogaj - Kamaran
Daut Xh. Foniqi - Llazicë

Murat Rr. Ajeti - Svircë
Ajet S. Bogiqi - Llapushnik
Hamdi Z. Thaçi - Llapushnik
Pajazit A. Krasniqi - Negroc
Mehmet R. Bujupi - Arllat
Muhamet F. Bujupi - Arllat
Selman A. Krasniqi - Negroc
Avdi B. Berila - Zabel i Poshtëm
Nazif Xh. Bujupi - Arllat
Sheremet Sh. Gashi - Negroc
Bajram J. Krasniqi - Tërpezë
Jakup J. Krasniqi - Negroc
Avdullah O. Thaçi - Llapushnik
Fetije H. Gashi - Arllat
Ymer A. Ibriqi - Kamaran
Nezir T. Shala - Negroc
Nuhi M. Haxhiu - Paklek
Avdi B. Gashi - Lutogllavë
Sahit A. Bujupi - Arllat
Shaban S. Bytyçi - Arllat
Idriz M. Gashi - Llapushnik
Xhemail A. Thaçi - Llapushnik
Avdyl J. Krasniqi - Negroc
Osman S. Shala - Negroc
Shani M. Bujupi - Arllat
Shkurije B. Stubllaku- Lluzhan
Milazim A. Dubruna - Arllat
Ibrahim Rr. Bujupi - Arllat
Ali D. Gara - Kizharekë
Shemsie H. Bujupi - Arllat

Sadie K. Ahmeti - Rahovicë-Preshevë
Svetlana R. Vujiçiq - Llukovac - Krushevë
Shefqet G. Zogaj - Lladroc
Azem M. Zogaj - Miradi e Epërme
Sylejman I. Zogu - Kamaran
Musa S. Tahiraj - Carabreg - Deçan
Petrit Sh. Rexhepi - Resen - Maqedoni
Hetem A. Haziraj - Vuçak
Ismet J. Thaçi - Llapushnik
Bukurie V. Thaçi -Llapushnik
Drita Xh. Krasniqi - Negroc
Agim J. Krasniqi - Negroc
Feride B. Gashi - Llapushnik
Salih M. Thaçi - Llapushnik
Bedrie Sh. Avdullahu - Zabel i Epërm
Milaim A. Bujupi - Arllat
Zrafete D. Haskaj - Pejë
Skënder A. Karaçica - Sankoc
Avdi H. Krasniqi - Negroc
Magbule H. Kryeziu - Bujupi - Arllat
Nada Z. Steviq - Kamenicë
Nexhmie H. Kuçi - Bujupi - Arllat
Gani Z. Morina - Arllat
Shefqet S. Bashota - Kamaran
Ilvi Xh. Dërguti - Rahovec
Ismail A. Bajraktari - Gillogoc
Shefqet M. Avdullahu - Zabel i Epërm
Mehdi A. Bucolli - Paklek
Xhemail Z. Krasniqi - Negroc
Zymer O. Krasniqi - Negroc

Shefqet M. Krasniqi- Negroc
Alush H. Bujupi - Arllat
Hajrie S. Bella - Zabel i Poshtëm
Luan S. Krasniqi - Tërpezë
Jahir B. Morina - Gllabar
Ramiz Xh. Bujupi - Arllat
Maliq K. Thaçi - Llapushnik
Naim D. Gashi - Nekoc
Fatime S. Ibrahimimi - Shupkoc
Asllan S. Hasani - Klinë - Skënderaj
Fazile S. Thaçi - Llapushnik
Gani F. Krsniqi - Negroc
Murat Z. Krasniqi - Negroc
Avdi A. Gashi - Llapushnik
Ismet T. Sopi - Llapushnik
Fidaim H. Berisha - Graboc i Poshtëm
Milosava Markoviq - Zhukoc-Istog
Mehdi S. Morina - Arllat
Haki H. Berisha - Kamaran
Sadik U.Krasniqi - Negroc
Latif S. Hoxha - Karraticë e Epërme
Shefqet B. Shala- Negroc
Tahir I. Bytyçi- Arllat
Maliq K. Thaçi - Llapushnik
Gani H. Shala - Negroc
Xhemshir H. Hoti - Tërstenik
Rabishe T. Thaçi - Llapushnik
Isa H. Krasniqi - Tërpezë
Hamit B. Bujupi - Arllat
Afrim H. Bujupi - Arllat

Istref B. Bujupi - Kamaran
Zeqir M. Bytyçi - Arllat
Kranimir Beseviq...
Shaip R. Gashi - Arllat
Ganimete M. Gashi - Arllat
Mujë Rr. Gashi - Llapushnik
Ismet H. Gashi -Negroc
Xheladin D. Bujupi - Arllat
Haki S.Krasniqi - Negroc
Miradie A. Gashi - Arllat
Fetah S. Thaçi - Llapushnik
Manush Krasniqi - Tërpezë
Dragan Tomoviq -Plavë
Milaim H. Gara - Kizharekë
Xheladin F. Gashi - Zabërgjë
Kamer I. Shala - Krojkovë
Ferat A. Shala - Kamaran
Mustafë A. Thaçi - Llapushnik
Isak H. Thaçi - Llapushnik
Shefqet Xh. Berisha - Berishë
Bali S. Gashi -Llapushnik
Fadil H. Seferi...
Asllan J. Bajrami - Shtuticë
Qemail M. Krasniqi - Tërpezë
Zymer H. Kryeziu - Mleçan
Ramadan L. Hoti - Tërstenik
Miftar M. Krasniqi - Tërpezë (Arllat)
Shaban E. Gashi - Arllat
Bedri I. Bytyçi-Arllat
Habib I. Gashi -Kievë

Florim N. Javori - Llazinë
Velko Popara - Gadijeko - Mali i Zi
Bislim Sh. Bujupi - Arllat
Shqipe D. Kryeziu - Mleçan
Elmi I. Gashi - Llapushnik
Sefer M. Krasniqi - Negroc
Afrim Z. Morina - Arllat
Adem I. Bytyçi - Arllat
Faik H. Gashi - Arllat
Ramadan M. Krasniqi - Tërpezë
Habib V. Krasniqi - Tërpezë
Muharrem Sh. Bujupi - Arllat
Mustafë O. Hoxha - Kamaran
Naile Z. Berisha - Llapushnik
Murat L. Bujupi - Arllat
Ismet J. Kastrati - Nekoc
Sofije I. Bytyçi - Arllat
Zoran M. Jovanoviq - Prishtinë
Bajram S. Thaçi - Llapushnik
Besa Ajazi - Hoti - Tërstenik
Ibrahim I. Gashi - Llapushnik
Xheva S. Gashi - Llapushnik
Gani S. Bujupi - Arllat
Zemrie A. Bujupi - Arllat
Ruzhdi Rr. Morina - Drenoc
Azem J. Shala - Vuçak
Fatime T. Bytyçi - Pejë (Novosellë)
Serbeze Sh. Bujupi - Prishtinë
Xhezair G. Jusufi-Sankoc
Azemine H. Bujupi - Arllat

Xhavit D. Bytyçi - Arllat
Muhamet I. Krasniqi - Negroc
Sokol M. Krasniqi - Negroc
Halim K. Lulaj - Klinë
Afrim Sh. Bujupi - Arllat
Qefesete B. Hoxha - Krojkovë
Drita Sh. Bogiqi - Prishtinë
Sefedin Sh. Dakaj - Cerovikë
Sofie A. Thaçi - Llapushnik
Vjollca L. Gashi - Llapushnik
Tefik L. Bujupi - Arllat
Sylejman Xh. Bytyçi - Arllat
Nexhmie Berisha - Bujupi - Arllat-Graboc
Besa R. Telaku - Bajë
Sabit RR. Gashi - Llapushnik
Ismail E. Gashi - Arllat
Fejzë S. Bytyçi - Arllat
Baki S. Bujupi - Arllat
Ahmet K. Bytyçi - Arllat
Mehdi N. Bytyçi - Arllat
Time R. Abazaj - Gllarevë
Shqipe I. Bytyçi - Arllat
Agim H. Bujupi - Arllat
Zukë Q. Morina - Arllat
Mendehie K. Bujupi - Arllat (Nekoc)
Shpresa M. Bujupi - Arllat
Merita J. Morina - Arllat
Hashim A. Bujupi - Arllat
Mujë I. Bujupi - Arllat
Milaim R. Bytyçi - Arllat

Naser M. Krasniqi - Negroc
Minire A. Bujupi - Arllat
Sahadete S. Bujupi-Arllat
Selvie N. Zogaj - Divjakë
Afërdita I. Bytyçi - Arllat
Setki F. Bujupi- Arllat
Drita I. Krasniqi - Tërpezë
Servete S. Bytyçi - Arllat
Fadil Bujupi - Arllat
Muharrem H. Bujupi - Arllat
Gani Z. Bujupi - Arllat
Mirjeta Xh. Bujupi - Arllat(Strugë)
Naser S. Morina - Arllat
Luljetë Sh. Krasniqi - Tërpezë
Veton S. Bujupi - Arllat
Vlora A. Dobruna - Arllat
Azem S. Bytyçi - Arllat
Qerime D. Gashi - Arllat
Mevlide Ramadani - Likoc
Nexhmie Istogu - Gashi - Palluzhë - Arllat
Rashit K. Thaçi - Llapushnik
Sefedin A. Bytyçi - Arllat
Fatmire M. Morina - Arllat
Naim Morina - Arllat
Shqipe D. Bujupi - Arllat
Lirie Rr. Gashi - Arllat
Bashkim M. Bujupi - Arllat
Flora H. Bytyçi- Arllat
Drita H. Hysenaj - Karraticë e Poshtme
Arben Gashi - Llapushnik

Syzana D. Bytyçi - Arllat
Avni Z. Morina - Arllat
Remzie Berisha - Shtrubulloë
Agron Duboci - Drenas
Isuf S. Thaçi - Llapushnik
Nazif B. Thaçi - Llapushnik
Kajtaç V. Krasniqi -Tërpezë
Januz B. Bujupi - Arllat
Nefise Tmava - Mazgit
Fatime Rr. Bujupi - Arllat
Leonora M. Jusufi- Sankoc
Ylber M. Haxhiu - Paklek i Ri

P.S.: Emrat e mbiemrat e punëtorëve të arsimit që punuan në Shkollën Fillore të Arllatit janë marrë nga Arkivi i shkollës.

NË PERIUDHËN 1946-2006 ME PROCESIN EDUKATIVO-ARSIMOR UDHËHEQËN KËTA DREJTORË:

1. Shyqri Palloshka - 1946-1949
2. Rasim Bujupi - 1949-1952
3. Shaqir Bujupi - 1952-1955
4. Xhemë Krasniqi - 1955-1956
5. Latif Gashi - 1956-1957
6. Rasim Bujupi - 1957-1958
7. Latif Gashi - 1958-1960
8. Emin Syliqi - 1960-1963
9. Xhemë Krasniqi - 1963-1966
10. Hamit Gashi - 1966-1969
11. Latif Gashi - 1969-1971
12. Idriz Morina - 1971-1972
13. Ahmet Dobruna - 1972-1980
14. Nezir Shala - 1980-1981

Grupi i dërguar nga Komiteti Komunal i LK-së udhëhoqi me procesin edukativo-arsimor të Shkollës Fillore të Arllatit:

Isak Krasniqi, Aziz Ramaj dhe Sahit Bujupi: 1981-1982

16. Hafir Bujupi - 1982-1983
17. Fetah Thaçi - 1983-1984
18. Salih Krasniqi - 1984-1986
19. Sahit Bujupi - 1986-1995
20. Naim Bujupi - 1995-1998
21. Isa Krasniqi, zëv. - 1998-1999
22. Naim Bujupi - 1999-2006

NGA SHKOLLA AMË “ABEDIN BUJUPI” E
ARLLATIT U PAVARËSUAN KËTO PARALELE TË
NDARA:

*Në vitin shkollor 1969/70 u pavarësua shkolla fillore
“Hasan Prishtina” e Tërpezës.*

*Në vitin shkollor 1985/86 u pavarësua shkolla fillore
“Jusuf Gërvalla” e Negrocit.*

*Në vitin shkollor 1990/91 u pavarësua shkolla fillore
“Hasan Prishtina” e Llapushnikut.*

Shkolla fillore “Rifat Berisha” në Zogaj - Berishë.

*Në vitin shkollor 2004/2005 u pavarësua shkolla
fillore “Mehdi dhe Sylejman Bytyçi” në Bytyç.*

XIXA KUJTIMI NË ALBUM



*Ndërtesa - shkollë e brezit të parë të shkollës shqipe
në Arllat (shtëpia e Bajram Hel Bujupit)*



*Pllaka përkujtimore e Abedin Salih Bujupit - dëshmor
i kombit, që rri ballëllart nga retë e qiellit, dhe sikur ditën
flet me popullin dhe me pavarësinë e Kosovës, flet me
shkollarë e shkollare, flet me arsimtarë dhe bashkëfshatarë,
flet me historinë dhe me Kosovën e lirë dhe porositë:*

*- Duajeni dheun e kësaj toke! Duajeni librin dhe
gjuhën!*

- Nderoni gjakun e derdhur për liri dhe pavarësi!



Muzeu i shkollës fillore “Abedin Bujupi” në Arllat, i themeluar nga Salih Krasniqi nga Tërpeza, ish-drejtor i kësaj shkolle.



Lapidari në Bytyç i dy çlirimtarëve dhe ushtarëve të UÇK-së, Mehdi dhe Sylejman Bytyçi, dëshmorë të kombit.



*Djali i dëshmorit Abedin Bujupi dhe drejtori i Shkollës
Filllore, Naim Bujupi. Vizatimin e portretit të dëshmorit e
bëri mr. Ylber Haxhiu.*



Mjeshtër duke vendosur kulmin e shkollës që ishte shkatërruar nga forcat e armikut gjatë luftës çlirimtare të UÇK-së (punët në renovimin e shkollës i kreu firma “Fatoni”, me pronar Xhavit Brahim Bujupi).



Çaste nga manifestimi i parë në Shkollën Fillore të Arllatit pas fitores së UÇK-së mbi robërinë shekullore. Degënaja kujtimi të paharrueshëm:

Ulur nga a djathta: Naim Bujupi, shef për çështje ushtarake dhe civile në Brigadën 121 “Kumanova”, Fadil Gashi, komandant i UÇK-së.

Në këmbë: Dr. Agim Bujupi, epror Tahir Sinani nga Tropoja, ushtar “Koburja” nga Baica e Lipjanit dhe Shaban Bujupi.



*Klubi i hendbollit i meshkujve të SHF "Abidin Bujupi"
në Arllat 2003/2004*



Hendbollistet e shkollës fillore "Abidin Bujupi" në Arllat



Lapidari afër shkollës, ku më 21 qershor 1999, ranë në terrenin e minuar Osman Krasniqi, Llapushnik, Sami D. Gashi, Arllat, Gareth Evans - KFOR, Balaram Rai - KFOR dhe Milazim Gashi, kurse Hysen Gashi u plagos.



Shkolla fillore “Abidin Bujupi” në Arllat

Kjo ndërtesë shkollore, shprehur figurativisht, i ngjan një koshereje me bletë. Ama e bletëve ishte kjo shkollë. Nga kjo koshere, si zakon që e kanë edhe bletët, sikur njerëzit, u ndanë disa simotra të tjera. Edhe ato bënë dhe bëjnë të njëjtën veprimtari bletësh: mbledhin nektarin nëpër lule gjithandej maleve e livadheve, arave e kopshteve, drurëve e barit dhe e grumbullojnë mjeshtërisht në koshere, ashtu sikur bëjnë shkollarë e shkollare në bankat e kësaj shkolle amë, të cilët, për dallim nga bletët, ata nektarin e dijes e mbledhin nëpër faqe librash.

Kushedi sa erëra e furtuna, kushedi sa dimra me borë e acar rënduan mbi kulmin e kësaj shkolle, e besa gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës, për shkak të humbjeve që pësoi nga pushka çlirimtare e luftëtarëve të lirisë, bisha

egërshane e ardhur nga Karpatet e largëta, pak pa i plasur zemra nga inati, hedh zjarrin brenda në shkollë dhe e djeg e pastaj edhe e rrënon fare. Por, nuk mposhtet, nuk shuhet, nuk fiket drita e Shkollës shqipe, nuk digjet dija as nuk asgjësohet dielli mbi krye të njerëzimit.

Ja si duket sot shkolla shqipe, si lule midis kopshtit, e mbushur brenda me bletë, që nektarin e dijes e mbledhin nëpër faqe librash.



Shkolla fillore "Hasan Prishtina" në Tërpezë



*Shkolla fillore pesëvjeçare në Lagjen e Xhamisë - paralele
e ndarë e amës në Arllat*



Shkolla filllore “Jusuf Gërvalla” në Negroc



Shkolla filllore “Mehdi e Sylejman Bytyçi” në Bytyç-Arllat.



Shkolla fillore pesëvjeçare në Gjergjaj - paralele e ndarë e amës në Arllat.



Shkolla fillore "Rifat Berisha" Berishë-Zogaj



Shkolla fillore “Hasan Prishtina” Llapushnik



Shkolla fillore “Tafil Kelmendi” në Balincë



Dikur ishin bashkë në një sofër, sot vepronë ndaras, por gjithherë me një gjuhë e këngë, me një abetare e qëllim:

Në foto, në mes: Shkolla fillore “Abedin S. Bujupi” dikur amë e këtyre shkollave, të cilat sot janë bërë shkolla më vete:

Shkolla fillore në Lagjen e Xhamisë, paralele e ndarë e amës, pastaj Shkolla e plotë fillore në Llapushnik, Shkolla fillore në Berishë-Zogaj-Malishevë, Shkolla fillore në Negroc, Shkolla fillore në Tërpezë-Malishevë, Shkolla fillore në Bytyç, Shkolla fillore në Balincë - Klinë, Shkolla fillore në Gjergjaj, paralele e ndarë e amës në Arllat.

Filluan para 80 vjetëve me 48 nxënës, e tani numërojnë afër 3000 nxënës. Është e nevojshme të bashkohen prapë në shkollë të mesme, këtu ku e kishin Amën.



Nxënës dhe arsimtarë para publikut të pranishëm nderojnë portretin e dëshmorit (2006)



Kori i shkollës duke kënduar himin kombëtar nën dirgjimin e arsimtarit Kajtaz Krasniqi, hap manifestimin e ditës së shkollës (15 maj 2006)



Nxënës dhe arsimtarë në rrugëtim për manifestimin e Epopesë së Grykës së Llapushnikut (9 maj 2001)



Riza Greiçevci, redaktor i librit, dhe Naim Bujupi, autori i monografisë (Drenicë, mars 2008)

BIOGRAFI



*Naim Bujupi, drejtor, duke folur
në ditën e shkollës (15 maj 2006)*

Naim Bujupi u lind më 17.04.1948, në Arllat të Drenicës. Shkollën fillore e mbaroi në vendlindje, të mesmen, Shkollën Normale në Mitrovicë, kurse Shkollën e Lartë Pedagogjike - dega politeknike në Prishtinë.

I ati i tij, Shaip Bujupi, ishte ndër kuadrot e para të mësuesisë. Në vitin 1954, autoritetet komuniste - politike të Jugosllavisë e të Serbisë e largojnë nga detyra e mësuesisë, me akuzë: i papërshtatshëm për arsim, përkatësisht kinse nuk kishte cilësi moralo-politike për mësimdhënie në shkollë.

Por, akuza se mësuesi shqiptar nga Arllati ishte punëtor i Sigurimit të Enver Hoxhës, ishte, sa absurde, aq edhe djallëzore, duke u përpjekur që të komprometohen mësuesit shqiptar politikisht e pastaj të ndjekeshin e përndjekeshin, të burgoseshin e besa edhe të likuidoheshin fare.

Të theksojmë se baba i mësuesit Shaip Bujupi, Hajdin Shaqir Bujupi, ishte ndër njerëzit e rrallë demokrat, me gjasë ishte anëtar i Partisë Demokratike të Nolit, kurse babai i Hajdinit, Shaqiri, vetë i dymbëdhjeti pushkatohet afër bjeshkëve të Astrazubit, duke e fajësuar për përpjekje për bashkim të trojeve të copëtuara shqiptare.

Naimi ishte pjesëmarrës në demonstratat e vitit 1968, në Mitrovicë, kurse në vitin 1981, ishte njëri ndër organizatorët e kësaj Pranvere të Rinisë Shqiptare të Kosovës, arrestohet dhe dënohet më 12 vjet burgim.

Shef i sektorit ushtarako-civil në Brigadën 121 “Ismet Jashari - Kumanova”, ndihmëskomandant i Brigadës.

Punoi shumë vite në edukimin dhe arsimimin e brezave, ishte nëntë vjet drejtor i shkollës fillore “Abedin Bujupi” në Arllat, për t’u larguar nga detyra e drejtorit si njeri i padëgjueshëm.

Sot është i papunë.

Në zgjedhjet e lira të nëntorit 2007, fiton votat për deputet në Kuvendin Komunal të Drenasit dhe, ndjehet tepër krenar për votën e anëtarësisë së PDK-së që e shpuri deputet i popullit.

FJALA E AUTORIT

Mjeshtri i shkollës, Manush Krasniqi, me pati thënë njëherë:

- Drejtor, shyqyr Zotit që kemi kaq shumë nxënës e nxënëse dhe, po merret vesh, ndodh ata me pahir mund të bëjnë edhe ndonjë sherr.

Gabimet dhe sherret e tyre i përmirësoj unë, me vullnet bile.

Merre me mend, drejtor, fliste mjeshtri i shkollës, kurse unë e përcillja ndërrimin psikologjik të fytyrës së tij, diku, atje, ndoshta shumëkund nëpër botë, ndodh, që në mungesë të nxënësve shkollarë të mbyllen fare shkollat. Mbyllen shkollat fare, sepse nuk ka së paku një nxënës që kapërcen pragun e shkollës dhe të ulet në bankën shkollore.

Shiko, drejtor, oborri i shkollës sonë plot nxënës e nxënëse. Zhurmojnë siç zhurmojnë bletët në koshere. Zëri i tyre është i ëmbël sikur mjalti. Shpesh, kur i shoh në oborr gjatë pushimit, me bëhen se këtu kanë zbritur yjet e qiellit.

A nuk ta çon mallin oborri i mbushur me shkollarë e shkollare si një kopsht me lule. Këta janë ushtarë e ushtare të Kosovës. Janë bilbila që do të ligjërojnë nesër e pasnesër, denbabaden, në gjuhën e bukurisë, në gjuhën e ardhmërisë.

Mirë e ke, Manush, me tamam, i thashë, sot qenke sikur një nxënës shembullor dhe ke fituar notën pesë.

Vëllai im, Halimi, kurbetçi në Gjermani në vitet e shtatëdhjeta, me pati thënë:

- Ta them drejt, në Gjermani mësova se dy janë ndër personalitetet e dorës së parë që nderohen nga toka në qiell:

Prifti që lidh besimtarët me Zotin, dhe mësuesi që brezave u falë nektarin e dijës!

Janë të vogla fjalët e mia, pasi tash monografinë për 80-vjetorin e shkollës shqipe në Arllat e keni në duar, lexues të nderuar. Qëmoti më ka djegur dëshira që brezave të rinj, gazetarëve, publicistëve e analistëve t'ua hartoj një monografi të shkurtër për historikun e shkollës shqipe në Arllat. Dhe, ja, lexues të nderuar, e keni në duar këtë vepër.

Nuk them se kam arritur të përmbledh, të sistemoj dhe t'i them të gjitha, të gjitha, të gjitha, ato që duhen thënë për rrugëtimin e shkollës shqipe sot e tetëdhjetë vjet më parë në Arllat.

Por, le të shërbejë kjo monografi për ndonjë ndërmarrje më të gjerë studiuese, pse jo, shkolla shqipe, historia, dija, lapsi është hise për të gjithë.

Kërkoj të falur nëse ndonjë emër, ngjarje apo theksim që do duhej kapur me lapsin e shkrimit, është harruar, ju siguroj, po të ketë ndodhur kjo, që mund t'i ndodhë secilit që merret me këso ndërmarrje publikimi, është e rastit, me pahir.

*25 mars 2008
Arllat-Drenas*

Naim BUJUPI

PËRMBAJTJA

NJOHURI PËR ARLLATIN.....	5
Celulat e para të arsimit shqip	9
SHKOLLARET E PARA TË TREVËS SONË	19
SALIJE HALIT BUJUPI – HOXHA	19
KADIJE BAJRAM BUJUPI – PEÇANI	21
HATIXHE HALIT BUJUPI – SYLAJ	23
O SOT O KURRË!	46
DËSHMORËT E KOMBIT DHE MARTIRËT	
NGA ARLLATI	49
ABEDIN Salih BUJUPI	49
ARBEN Avdullah SHALA	53
BEDRI Veli SHALA	54
BEDRI Habib GASHI	56
BASHKIM Mustafë BUJUPI	58
FEHMI Minush MORINA	60
GËZIM Haxhi MORINA.....	62
HAMIT Jetish GASHI.....	64
ISMAIL Dan BYTYÇI.....	66
LULËZIM Metë BUJUPI.....	68
MENTOR Naim GASHI	69
MEHDI Nebih BYTYÇI	71
MEHDI Sylë MORINA.....	73
MILAZIM Rrahim GASHI	75
OSMAN Adem KRASNIQI.....	77
RAMADAN Emin BYTYÇI.....	79
RRAHMAN Islam GASHI.....	81
SAMI Daut GASHI	82
SYLEJMAN Xheladin BYTYÇI.....	84
SYLË Jakup MORINA.....	86

A VRITET FËMIJA?	87
ARMIKU RRËNOI GODINËN E SHKOLLËS SHQIPE.....	89
XIXA KUJTIMI NË ALBUM	107
BIOGRAFI	124
FJALA E AUTORIT	127

*Falënderoj për zemërsisht sponsorin e kësaj monografie për arsimin shqip të Arllatit Firmën “**FORTESA**” nga Prishtina.*

Autori Naim Bujupi

Katalogimi në botim - (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

37(496.51)(092)

Bujupi, Naim

Rrugëtimi i shkollës shqipe në Arllat 1928-2008 / Naim Bujupi. - Prishtinë : “Grafoprint”, 2008. - 131 f. : ilustr. ; 14,5 x 21 cm.

Biografi : f. 89-90

ISBN 978-9951-8751-5-8